

Republika e Shqipërisë  
Zyra e Noterisë Tiranë  
Nr. 2720 Rep.  
Nr. 364 Kol.



**— KONTRATË —**

**(Për premtim shitjeje)**

Sot, më datë 20.09.2012 (dy mijë e dymbëdhjetë), nënshkruhet përpara meje noter Drita Pepi, me seli në adresën Rruga Gjergj Fishta, pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, kjo kontratë për premtim shitjeje (këtu e tutje referuar si kontrata) si më poshtë:

**Palët:**

Shoqëria "LNK" shpk, me NIPT K02003004P, me administrator të vetëm Z. Taip Kurti me seli në adresën Rruga Reshit Collaku, Pallati i ri, Kati i dytë, mbrapa Shallvareve, Tiranë, referuar këtu e tutje si "premtuesi";

*dhe*

Shoqëria "A.S.K Oil" sh.a., me NIPT K82109004K, me administrator të vetëm Z. Jorgo Mano me seli në adresën Rruga Komuna e Parisit, Pallati "Tre Kullat Erald", shkalla 3, apartamenti 17. Tiranë, referuar këtu e tutje si "përfituesi";

*të cilët do të njihen bashkërisht si palët.*

Duke konsideruar bisedimet dhe komunikimet e mëparshme që çuan në nënshkrimin e kësaj kontrate palët bien dakord si më poshtë.

**Neni 1 - Qëllimi i Kontratës.**

Palët lidhin këtë kontratë pasi premtuesi ka në pronësi të tij kuota të shoqërisë koncesionare të krijuar në kuadrin e koncesionit "Ura e Prenit" për financim, projektim, ndërtim, vënie në punë, administrim dhe mirëmbajtje e hidrocentraleve në lumin Bushtrica nga kuota 820 metra deri në kuotën 1600 metra.

Premtuesi dhe Përfituesi janë të dy ortakë të shoqërisë koncesionare "Bushtrica Energy 2009" shpk me NIPT K98505601E.

Palët kanë nënshkruar me Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës kontratën e koncesionit me nr. 2829 Rep. dhe nr. 373 kol., datë 03.09.2009.

Përfituesi është në dijeni të faktit që premtuesi kërkon të shesë këto kuota dhe për këtë gjë ky i fundit ka kryer disa takime konfidenciale me disa blerës të tjerë potencial. Përfituesi kërkon nga premtuesi nënshkrimin e kësaj kontrate për premtim shitjeje me qëllimin që të jetë i sigurt që

Nënshkrimi

Faqe 1 nga 4

Nënshkrimi

nëse ai paguan vlerën e përcaktuar në këtë kontratë premtuesi do t'i shesë vetëm atij kuotat e shoqërisë koncesionare.

### **Neni 2 – Objekti i kontratës.**

Premtuesi angazhohet t'i ofrojë për shitje vetëm përfituesit 39% (tridhjetë e nëntë përqind) të kuotave që ai disponon në shoqërinë "Bushtica Energy 2009" shpk sapo përfituesi të ketë paguar të gjithë vlerën e parashikuar në këtë kontratë sipas mënyrës dhe kushteve të parashikuara në këtë kontratë.

Përfituesi është në dijeni të të gjitha vendimeve dhe të gjithë praktikës së METE që lidhen me koncesionin "Ura e Prenit". Përfituesi është në dijeni që këto vendime janë bërë objekt i procedurave gjyqësore të cilat kanë përfunduar me sukses në gjykimin e çështjes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Përfituesi është në dijeni të faktit që ky vendim është ankimuar dhe mund të ndryshohet nga Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Lartë apo çdo lloj gjykate tjetër (gjykata e ndonjë rrethi tjetër, Gjykata Kushtetuese etj...). Përfituesi dëshiron që kjo kontratë të jetë krejtësisht e pavarur nga rezultati i këtyre procedurave gjyqësore dhe që ajo nuk mund kurrsesi të cenohet nga fakte apo vendime të çfarëdo institucioni që lidhen me koncesionin "Ura e Prenit".

### **Neni 3 – Shuma**

Përfituesi duhet t'i paguaj premtuesit shumën prej 455 000 (katër qind e pesëdhjetë e pesë mijë) Euro sipas kësteve të mëposhtme:

1- **30 000 (tridhjetë mijë) Euro** në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate pranë një noteri.

2- **Shumën prej 425 000 (katër qind e njëzet e pesë mijë) Euro** deri në datën 28 Tetor 2012.

Premtuesi bie dakord që nëse shuma totale prej 455 000 (katër qind e pesëdhjetë e pesë mijë) Euro nuk është paguar e plotë deri në datën 28 Tetor 2012 ai të tregoj një tolerancë prej maksimalisht 3 (tre) ditësh kalendarike (deri në datën 31 Tetor 2012 ora 22:00).

Pagesa do të bëhet vetëm në bankë në llogarinë e premtuesit si vijon:

Banka: Banka Kombëtare Tregtare, Dega Rruga e Elbasanit pranë Shkollës Jordan Misja Tiranë.  
Nr. 403160935.

### **Neni 4 – Pasojat e mospagesës së shumës totale të kësaj kontrate.**

Nëse shuma totale prej 455 000 (katër qind e pesëdhjetë e pesë mijë) Euro nuk është paguar e plotë deri në datën e sipër përmendur (28 Tetor 2012 + 3 ditë tolerancë) atëherë kjo kontratë premtim shitjeje konsiderohet automatikisht e zgjidhur pa pasur nevojë të kryhet asnjë formalitet.

Nëse kontrata zgjidhet në zbatim të parashikimit të mësipërm çdo shumë që përfituesi i ka paguar premtuesit mbetet në pronësi të premtuesit dhe është e pakthyeshme. Përfituesi nuk mund të kërkojë rikthimin e asnjë shume të paguar prej tij në zbatim të kësaj kontrate dhe nuk mund të kërkojë asnjë dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës për shkakun e mospagesës së tërësishme të shumës së sipër përmendur.

**Neni 5 – Detyrimet e premtuesit.**

Premtuesi detyrohet që deri në datën 1 Nëntor 2012 të mos i shesë asnjë personi të tretë asnjë prej kuotave që ai zotëron tek shoqëria koncesionare “Bushtrica Energy 2009” shpk.

Premtuesi detyrohet që, nëse shuma prej 455 000 (katër qind e pesëdhjetë e pesë mijë) Euro është paguar brenda datës 31 Tetor 2012, t’i shesë përfituesit kuotat e shoqërisë koncesionare “Bushtrica Energy 2009” shpk që janë në pronësi të tij duke nënshkruar një kontratë shitjeje përpara një noteri.

**Neni 6 – Detyrimet e përfituesit.**

Përfituesi detyrohet të paguajë shumën prej 455 000 (katër qind e pesëdhjetë e pesë mijë) Euro brenda datës 28 Tetor 2012.

**Neni 7 – Kontrata e shitjes**

Përfituesi është në dijeni të kërkesave ligjore sipas së cilave për shitjen e kuotave të shoqërisë “Bushtrica Energy 2009” shpk nevojitet miratimi i Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës (referuar si METE). Përfituesi duhet të marrë aprovimin nga METE për këtë shitje.

Nëse aprovimi i sipër përmendur merret nga METE përpara se përfituesi të ketë paguar të gjithë shumën prej 455 000 Euro (në çdo rast jo më vonë se data 31 Tetor 2012) atëherë sapo përfituesi të paguajë tërësinë e shumës do të lidhet kontrata e shitjes.

Përfituesi kërkon që nëse, në momentin kur ka paguar të gjithë vlerën e parashikuar në këtë kontratë sipas mënyrës dhe kushteve të parashikuara në këtë kontratë, ai nuk ka marrë ende këtë miratim nga METE atëherë të nënshkruhet mes këtyre palëve një kontratë shitjeje me kusht e cila të parashikojë që shitja do të bëhet efektive sapo përfituesi (ose blerësi në atë kontratë shitjeje me kusht) të ketë arritur të marrë miratimin e METE.

Kontrata e shitjes ose e shitjes me kusht sipas parashikimeve të mësipërme do të parashikojë një çmim të barabartë me vlerën nominale të kuotave siç figuron e regjistruar në QKR në momentin e nënshkrimit të saj. Nëse ky çmim është më i vogël se vlera prej 455 000 Euro e paguar nga

përfituesi atëherë premtuesi bie dakord që nuk do të kërkojë pagimin e çmimit të kontratës së shitjes apo të shitjes me kusht.

Kontrata e shitjes apo e shitjes me kusht nuk mund të ngarkojë mbi premtuesin (shitësin në atë kontratë) asnjë detyrim përveç detyrimit për të transferuar pronësinë e kuotave dhe (në rastin e shitjes me kusht) detyrimin për të mos ia shitur askujt tjetër ato kuota për sa kohë kontrata e shitjes me kusht do të jetë e vlefshme.

### Neni 8 – Njoftimet

Palët bien dakord që të gjitha njoftimet do të bëhen vetëm në adresat e mëposhtme të postës dhe emailit:

#### Për premtuesin:

Adresa: Rruga Reshit Collaku, Pallati i ri, Kati i dytë, mbrapa Shallvareve, Tiranë,

Emaili: [taip\\_kurti@hotmail.com](mailto:taip_kurti@hotmail.com) dhe [lnkshpk@yahoo.com](mailto:lnkshpk@yahoo.com)

#### Për përfituesin:

Adresa: Rruga Komuna e Parisit, Pallati "Tre Kullat Erald", shkalla 3, apartamenti 17, Tiranë.

Emaili: [eurochem\\_it@yahoo.com](mailto:eurochem_it@yahoo.com)

### Neni 9 – Të tjera:

Kjo kontratë nuk është një kontratë shitjeje, dhurimi apo tjetërsimi dhe si e tillë nuk transferon asnjë të drejtë reale mbi kuotat e shoqërisë koncesionare "Bushtrica Energy 2009" shpk

Kjo kontratë i jep të drejtë përfituesit për të bllokuar pjesën e kuotave të shoqërisë koncesionare "Bushtrica Energy 2009" shpk që është në pronësi të premtuesit deri në datën 6 Nëntor 2012.

Përtej kësaj date kuotat nëse janë bllokuar konsiderohet se janë të lira dhe mund të zhbllokohet me kërkesë të premtuesit nëse nuk janë zhbllokuar automatikisht.


Kjo kontratë është konfidenciale dhe mund të depozitohet për t'u regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vetëm për bllokim deri në datën 6 Nëntor 2012.

#### Për premtuesin

Shoqëria "LNK" shpk

Përfaqësuesi ligjor

(emër, mbiemër, firmë)



#### Për përfituesin

Shoqëria "A.S.K Oil" sh.a.

Përfaqësuesi ligjor

(emër, mbiemër, firmë)



Nenshkrimi

Faqe 4 nga 4

*Nolene*  
*Drita B. Pepi*



## EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NIPT)	K98505601E
2. Data e Regjistrimit	05/11/2009
3. Emri i Subjektit	Bushtrica Energy 2009
4. Forma ligjore	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
5. Data e themelimit	02/11/2009
6. Kohëzgjatja	Nga: 02/11/2009 Deri:
7. Selia	Elbasan Librazhd LIBRAZHD Lagjja 1,pallati 7, shkalla 1.
8. Kapitali	1.000.000,00
9. Numri i pjesëve	1.000,00
9.1 vlera nominale	1.000,00
10. Të dhëna mbi shlyerjen e kapitalit	
11. Objekti	Financim, projektim, ndertim, venie ne pune, administrim, dhe mirembajtje e hidrocentraleve ne lumin e Bushtrices nga kuota 385 metra deri ne kuoten 1600 metra dhe transferimin e tyre nga koncesionari tek autoriteti kontraktues sipas kontrates se koncesionit te firmosur ndermjet paleve krijuese te shoqerise dhe Ministrise se Energjitikes.
12. Përfaqësuesit ligjor	Xhavit Ujkani
Afati i emërimit	Nga: 02/11/2009 Deri: 02/11/2014



13. Kufizime të kompetencave	
14. Përfaqësuesit ligjor Afati i emërimit	Ilmi Loshi Nga: 22/02/2010 Deri: 22/02/2015
15. Kufizime të kompetencave	
16. Përfaqësuesit ligjor Afati i emërimit	Xhezmi Kadi Nga: 02/11/2009 Deri: 02/11/2014
17. Kufizime të kompetencave	
18. Përfaqësuesit ligjor Afati i emërimit	Luan Kurti Nga: 02/11/2009 Deri: 02/11/2014
19. Kufizime të kompetencave	
20. Ortakët Pjesët e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	ERNIKU 230,00 23,00
21. Ortakët Pjesët e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	LOSHI BL 100,00 10,00
22. Ortakët Pjesët e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	A. S. K. OIL 280,00 28,00
23. Ortakët Pjesët e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	LNK 390,00 39,00
24. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
25. Të dhëna njoftuar vullnetarisht	Emri Tregtar: Bushtrica Energy 2009 Telefon: 0682001182 0682058840 Të Tjera: Ne baze te vendimit dt. 22-02-2010 eshte vendosur ndryshimi i nenit 20 te Statutit te Shoqerise.
26. Statusi	Aktiv

## HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e regjistrimit	Ndryshimi i të dhënave të regjistruara
1. 18/03/2010	<p>Numri i ceshtjes: CN-360340-03-10 <u>Objekti</u> ishte ( "Financim, projektim, ndertim, venie ne pune, administrim, dhe mirembajtje e hidrocentraleve ne lumin e Bushtrices nga kuota 390 metra deri ne kuoten 1450 metra dhe transferimin e tyre nga koncesionari tek autoriteti kontraktues sipas kontrates se koncesionit te firmosur ndermjet paleve krijuese te shoqerise dhe Ministrise se Energjitikes." ) u be ( "Financim, projektim, ndertim, venie ne pune, administrim, dhe mirembajtje e hidrocentraleve ne lumin e Bushtrices nga kuota 385 metra deri ne kuoten 1600 metra dhe transferimin e tyre nga koncesionari tek autoriteti kontraktues sipas kontrates se koncesionit te firmosur ndermjet paleve krijuese te shoqerise dhe Ministrise se Energjitikes." )</p> <p><u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek administratoret</u> Eshte shtuar administratori: ( <b>Ilmi Loshi</b> ) ,Nga Data "22/02/2010" ,Në Datën "22/02/2015"</p> <p><u>Koment</u> ishte ( "" ) u be ( "Ne baze te vendimit dt. 22-02-2010 eshte vendosur ndryshimi i nenit 20 te Statutit te Shoqerise." )</p> <p>Lista e Dokumenteve: <u>Aplikim per ndryshime ne te dhenat e regjistrimit</u> <u>Regjistrime te tjera sipas nenit 45 te ligjit per OKR</u></p>
2. 12/07/2011	<p>Numri i ceshtjes: CN-572629-07-11</p> <p>Arsyet e hapjes se ceshtjes: <i>Depozitim i urdherit nr.5796 Prot, nr.283-11 Regj, date 05.07.2011, " Per Venien e Sekuestros Konservative", e leshuar nga Shoqeria "Sherbimi Perambarimor ZIG" shpk drejtuar OKR, ku eshte urdheruar: 1.Vendosjen e mases se sekuestros konservative ne aktivet e shoqerise "Ineva" shpk, NIPT K02009002G dhe shoqerise "Jollanda-2008" shpk me NIPT K81621024F si dhe ne aktivet qe zoterojne ne shoqerite e tjera te regjistruara prane jush z Xhezmi Safet Kadi, dtl.16.08.1959,znj.Jollanda Nako Kadi, dtl.15.01.1969 dhe z.Alfred Niazi Rumani dtl.19.10.1959. 2. Aktivet e mesiperme do te qendrojne te sekuestruara deri ne nje urdherese te dyte nga ana e jone.</i></p> <p>Lista e Dokumenteve: <u>Aplikim per ndryshime ne te dhenat e regjistrimit</u></p>
3. 21/03/2012	<p>Numri i ceshtjes: CN-720499-03-12</p> <p>Arsyet e hapjes se ceshtjes: <i>Depozitimi i Vendimit Nr.283-11 Regj, Nr.06279 Prot date 15.03.2012 "Per perjashtimin e Sendit nga Sekuestro" e leshuar nga Shoqeria "Sherbimi Perambarimor Zig" shpk drejtuar OKR, ku eshte vendosur:1. Perjashtimin nga sekuestrimi dhe nga procedura vijuese perambarimore te aksioneve te shoqerise "A.S.K.OIL" sha, te</i></p>






sekuestruara per ekzekutimin e Urdherit te ekzekutimit Vendimi nr.2002 Akti date 29.06.2010 i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane. 2.Perjashtimi nga sekuestro shtrihet mbi te gjitha aktivet ne zoterim te Jorgo Mano, qe figurojne te regjistruara prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Depozitimi i Vendimit Nr.1047 date 07.02.2012 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Lista e Dokumenteve:

Regjistrime te tjera sipas nenit 45 te ligjit per OKR

Aplikim per ndryshime ne te dhenat e regjistrimit

Date: 01/08/2012

  
Emri, Mbiemri  
(i nëpunësit të sportelit)



## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NIPT)	K02003004P
2. Data e Regjistrimit	03/08/2000
3. Emri i Subjektit	LNK
4. Forma ligjore	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
5. Data e themelimit	27/07/2000
6. Kohëzgjatja	Nga: 27/07/2000 Deri:
7. Selia	Tirane Tirane TIRANE NAIM FRASHERI P60/3 5/1
8. Kapitali	200.100.000,00
9. Numri i pjesëve 9.1 vlera nominale	200.100,00 1.000,00
10. Të dhëna mbi shlyerjen e kapitalit	
11. Objekti	Ndertim te veprave te ndryshme.
12. Përfaqësuesit ligjor Afati i emërimit	Taip Kurti Nga: 25/05/2011 Deri: 25/05/2016
13. Kufizime të kompetencave	
14. Ortakët Pjesët e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	Naimir Kurti 180.090,00 90,00



15. Ortakët	Taip Kurti
Pjesët e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	20.010,00 10,00
16. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Kashar KASHAR Fshati Yzberisht, Komuna Kashar. Tirane Tirane TIRANE KAVAJES Tirane Tirane TIRANE SELAUDIN ZORBA Tirane Tirane TIRANE DON BOSKO Tirane Tirane TIRANE ALI BAUSHI PR SPITALIT FEMIJE Tirane Kashar KASHAR YRSHEK-KASHAR-LEJE NDERT.NR.13 Tirane Kashar YZBERISH Ndertim i nje Objekti banimi e shebimesh 2,7,9 kat, nje kat nen toke, Yzberisht
17. Të dhëna njoftuar vullnetarisht	Emri Tregtar: LNK Telefon: 236081
18 Statusi	Aktiv

Data: 11-09-2012

*Arta Rog*  
Emri, Mbiemri  
(i nëpunësit të sportelit)

*11-09-2012*



## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ANONIME SH.A."

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NIPT)	K82109004K
2. Data e Regjistrimit	09/09/2008
3. Emri i Subjektit	A. S. K. OIL
4. Forma ligjore	Shoqëri Anonime
5. Data e themelimit	02/09/2008
6. Kohëzgjatja	Nga: 02/09/2008 Deri: 2038-09-02T00:00:00
7. Selia	Tirane Kamez VALIAS Fshati Valias i Ri, Godine 2 Kateshe, nr.6
8. Kapitali	2.000.000,00
9. Numri i Kontributeve vlera nominale	100,00 20.000,00
10. Të dhëna mbi shlyerjen e kapitalit	
11. Objekti	Import-Eksport dhe tregtim me shumice i naftes, gazit dhe nenprodukteve të tyre
12. Përfaqësuesit ligjor Afati i emërimit	Jorgo Mano Nga: 21/09/2011 Deri: 21/09/2016
13. Kufizime të kompetencave	
14. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës Afati i emërimit	Anisa Kume Nga: 20/03/2009 Deri:
15. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës	Xhezmi Kadi



Afati i emërimit	Nga: 02/09/2008 Deri: 02/09/2011
16. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës Afati i emërimit	Vasilika Kume Nga: 02/09/2008 Deri: 02/09/2011
17. Eksperti Kontabël i Autorizuar Afati i emërimit	Arif Sanxhaku Nga: 02/09/2008 Deri: 31/12/2008
18. Aksioner Kontributet e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	Jorgo Mano 100,00 100,00
19. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Shkoder Rrape RRAPE Fshati Rrape, komuna Rrape, prane kompleksit te depozitave te shtetit.
20. Të dhëna njoftuar vullnetarisht	Emri Tregtar: A. S. K. OIL E-Mail: 0682023775
21. Statusi	Aktiv



Datë: 11-09-2012

*Anila Raci*  
Emri, Mbiemri  
(i nëpunësit të sportelit)



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
ZYRA E NOTERISË TIRANË

NR. 2889 Rcp.  
NR. 373 Kol.



### KONTRATË KONCESIONI

E FORMËS "BOT" (NDËRTIM - OPERIM - TRANSFERIM)  
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE  
NE RRJEDHEN E LUMIT BUSHTRICË, RRETHI LIBRAZHD.

Në Tiranë, më datë 03/09/2009 (dy mijë e nëntë), para meje Noter Edmond B. Jocka, anëtar i  
Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë R. Durrës 118 S.F.T. Tpl, u paraqitën  
palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që më poshtë do të quhet "AUTORITET  
KONTRAKTUES", përcaktuar si i tillë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 707, datë  
07.07.2008 "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie me koncesion të hidrocentralit  
"Ura e Prenit" dhe miratimin e bonusit në procedurën për zgjedhje konkurruese që i jepet shoqërisë",  
përfaqësuar nga Titullari, z. Genc RULI, i biri i Pellumbit, i datëlindjes 11/04/1958, madhor dhe me  
zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr. D0000374.

DHE

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "L.N.K" sh.p.k, "Erniku" sh.p.k, "A.S.K Oil" sha dhe "Loshi  
BL" sh.p.k, që në vijim do të quhet "KONCESIONARI", i formuar sipas marrëveshjes nr. 2607  
Kol, nr. 6067 Rep, datë 28/08/2009 me këto të dhëna:

Shoqëria "L.N.K" shpk, e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKR me NIPT K02003004P  
dhe date 12/02/1998 regjistrimi; me seli në Tiranë, përfaqësuar ligjerisht në këto kontrate nga  
administratori i shoqërisë Z.Taip KURTI, i biri i Luanit, i datëlindjes 12/09/1964, madhor dhe me  
zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr. Z 1111644.

Shoqëria "Erniku" shpk, e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKR me NIPT  
J71925004S, me seli në Tiranë, përfaqësuar ligjerisht në këto kontrate nga administratori i shoqërisë  
Z. Iljaz SPAHIU, i biri i Emriut, i datëlindjes 05 / 07 / 1969, madhor dhe me zotësi juridike  
për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr. Z 1263405.

Shoqëria "A.S.K Oil" sha, e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKR me NIPT  
K82109004, me seli në Tiranë, përfaqësuar ligjerisht në këto kontrate nga administratori i shoqërisë  
Z. Andi KUME, i biri i Thimios, i datëlindjes 11 / 12 / 1983, madhor dhe me zotësi juridike  
për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr. Z 1472536.

Faqe 1 nga 28

KONTRATE KONCESIONI E FORMES "BOT"

*[Handwritten signatures and stamps of the parties and the notary]*

Shoqëria "Loshi BL" shpk, e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKR me NIPT J67902618M, me seli në Librazhd, prfaqesuar ligjerisht në këtë kontratë nga administratori i shoqërisë Z. Bajram LOSHI, i biri i Shajdanit, i datëlindjes 1.10.1962, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta nr. Z 1044592.

### Hyrje

Duke patur parasysh se:

#### Qeveria e Shqipërisë:

1. I ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj ose rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistues me anë të procedurave të koncesionit, për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të rrejtë elektrik kombëtar;
2. Konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë.
3. Vlerëson formën "BOT" të koncesionit, si një formë koncesioni që bën të mundur nxitjen e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj me anën e kapitalit privat;
4. Është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të-brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;
5. Mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike.

#### Koncesionari:

1. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për ndërtimin dhe operimin e hidrocentraleve të sipërpërmendur, si një propozim i pakërkuar, dhe në përfundim të procedurës përzgjedhëse konkurruese është vlerësuar si ofertuesi më i mirë.
2. Është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentraleve përkatës në rrjedhën e lumit Bushtricë, rrethi Librazhd, me qëllim prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të zonës;
3. Zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiare, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj marrëveshje;
4. Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Palët lidhin këtë kontratë koncesioni bazuar në Ligjin nr.9663 dt.18.12.2006 "Për koncesionet" i ndryshuar, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 07.07.2008 "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Ura e Prenit" dhe

Faqe 2 nga 28

KONTRATE KONCESIONI E FORMES "BOT"

*(Handwritten signatures and stamps)*

miratimin e bonusit ne proceduren perzgjedhese konkurruese qe i jepet shoqerise" dhe bien dakord per sa me poshte:

## KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizime dhe interpretime

1. Kudo që në këtë Kontratë përdoren termat e mëposhtme, ato do të kenë kuptimet përkatëse si vijon:
  - 1.1. **Kontrata e Koncesionit:** Kjo kontratë, anekset dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.
  - 1.2. **Ligji "Për Koncesionet":** Ligji Nr.9663, datë 18.12.2006 "Për Koncesionet", i ndryshuar.
  - 1.3. **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
  - 1.4. **Koncesionari:** Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "L.N.K"sh.p.k, "Erniku"sh.p.k, "A.S.K Oil"sh.a dhe "Loshi BL"sh.p.k, ku Shoqëria "Erniku" sh.p.k. me seli ne qytetin e Tiranës, është përcaktuar si koordinator i projektit me Autoritetin Kontraktues gjate gjithë kohezgjatjes se koncesionit.
  - 1.5. **Hidrocentralet:** Hidrocentralet qe do te ndertohen, me vendndodhje ne rjedhen e lumit Bushtricë, rrethi Librazhd, me fuqi totale të instaluar 29.770 (njetzenentemije e shtateqindeshtatedhjetë) kW dhe prodhim mesatar vjetor të energjisë elektrike 136,542,426 (njqendetridhjetegjashtemilion e peseqindedyzetedyrije e katerqindenjetegjashte) kWh, i përbërë nga tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë, por pa u kufizuar në to: veprën e marrjes, kanalin e devijimit, bazenin e presionit, tubacionin që dërgon ujin në turbina, lidhjen me sistemin, ndërtesën e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e intaluara në të.
  - 1.6. **Objekti:** Financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentraleve dhe transferimi i tyre nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
  - 1.7. **Projekti:** (i) projektimi, financimi, ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe transferimi i pronësise se hidrocentraleve ne lumin Bushtricë tek Autoriteti Kontraktues dhe (ii) zgjerimi i Objekteve Ekzistuese (nese ka), pronesia e objekteve Ekzistuese te zgjeruara (nese zgjerohen) dhe mirëmbajtja e te gjithë Objekteve Ekzistuese.
  - 1.8. **Investimi:** Vlera totale në lekë që do të shërbejë për ndërtimin dhe pajisjen me makineritë e nevojshme të hidrocentraleve, deri në fillimin e prodhimit të energjisë elektrike.
  - 1.9. **Punimet:** Tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik, ndërtimin dhe vënien në punë të 12 hidrocentraleve në përputhje me projektin e zbatimit, duke perfshire te gjitha punimet civile te nevojshme dhe instalimet elektro - mekanike, qe perfshin, por pa u kufizuar vetem tek turbinat, gjeneroret, pajisjet ndihmese per ndertesën e centralit, transformoret pajisjet e nënstacionit dhe linjat e transmetimit tek Pika e levrimit me rrjetin elektrik shqiptar.

Faqe 3 nga 28

KONTRATE KONCESIONI E FORMES "BOT"

*[Handwritten signatures and stamps are present at the bottom of the page, including a large circular stamp on the right side.]*

- 1.10. **Pika e Levrimit:** Pika për të cilën koncesionari ka rënë dakord me OST (Operatori i Sistemit të Transmetimit) që gjendet në anën e tensionit të lartë të transformatorit rrites ose të nënstacionit në pronësi të koncesionarit dhe të pajisjeve të rrjetit të transmetimit në pronësi (ose që do të jenë në pronësi) të OST në përputhje me Ligjin "Për Sektorin e Energjisë" dhe nëpërmjet të cilit Prodhimi Neto i Energjisë Elektrike kalon nga kontrolli dhe risku i koncesionarit tek rrjeti i transmetimit.
- 1.11. **OST** do të thotë shoqëria OST Sh.A, e cila është operatori i sistemit të transmetimit për rrjetin elektro – energjistik kombëtar të Shqipërisë.
- 1.12. **Fillimi i punimeve:** Zbatimi i projektit pas miratimit të tij sipas Nenit 8.2 të kësaj kontrate.
- 1.13. **Vënia në punë e hidrocentraleve:** Fillimi i prodhimit të energjisë elektrike pas testimit sipas Nenit 11 të kësaj kontrate.
- 1.14. **Kontratat:** Të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari, me sipërmarrësit për realizimin e punimeve ose çdo marrëveshje tjetër e lidhur me të tretët që ka si objekt operimin e hidrocentraleve dhe/ose sigurimin e fondeve financiare.
- 1.15. **Leje dhe Liçenca:** Akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatëse publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin në fuqi, në veçanti të gjitha lejet, autorizimet, licencat dhe miratimin e ERE (Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike), për ndërtimin, instalimin dhe/ose mirëmbajtjen, të kërkuar për zbatimin dhe përmbushjen e kësaj kontrate.
- 1.16. **Operimi:** Të gjitha veprimet e koncesionarit për prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.
- 1.17. **Tarifa koncesionare:** Sasia vjetore e energjisë elektrike e shprehur në përqindje, që i jepet pa pagesë Autoritetit Kontraktues.
- 1.18. **Llogaritja e afateve:** Kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të kësaj muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.
- 1.19. **Data Efektive:** Nënkupton datën në të cilën kjo Kontratë nënshkruhet nga palët para Notarit publik.
- 1.20. **Subjekti i furnizimit me energji elektrike:** Personi i liçencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit shqiptar.
- 1.21. **Sigurimi i kontratës:** Vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme ose në një shoqëri sigurimesh, me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kontratës nga Koncesionari, sipas Nenit 14.
- 1.22. **Ligj:** Nënkupton çdo ligj organik, dekret, vendim të Këshillit të Ministrave ose çdo ligj tjetër që shpallet si i tillë, rregullorë, udhëzim, urdhër, licensë, leje, autorizim ose çdo akt tjetër ligjor i shpallur nga Republika e Shqipërisë, vendime gjyqësore që kanë karakter unifikues,

akte zyrtare të lëshuara nga çdo organ qëndror dhe/ose vendor, ashtu siç mund të ndryshojnë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.

- 1.23. **Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE):** Është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike që vepron sipas Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, i ndryshuar.
- 1.24. **Aneks:** Çdo deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga palët që i bashkëlidhet kësaj Kontrate, si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj, tani apo në të ardhmen.
- 1.25. **Instrument Financiar:** Nënkupton çdo marrëveshje huaje, kredie, marrëveshje sigurorese ose çdo instrument tjetër i përdorur nga Koncesionari në lidhje me financimin e objektit të këtij koncesioni, duke përfshirë çdo ndryshim, shtesë, rinovim apo zëvendësim të secilit prej këtyre instrumenteve.
- 1.26. **Palë Financuese:** Nënkupton çdo person ose persona që japin kredi për financime ose rifinancime në formën e kontratave të huamarrjes, bonove, obligacioneve, marrëveshjeve të sigurimit të detyrës, deklaratave të regjistrimit ose informimit, marrëveshjeve të varesise, hipotekave, akteve të perfaqesimit dhe administrimit, marrëveshjeve të kredise, marrëveshjeve për blerjen e bonove ose obligacioneve, marrëveshjeve të pjesëmarrjes dhe dokumentave të tjera, ndaj Shoqërisë Koncesionare në lidhje me projektimin, prokurimin, ndertimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e objektit të koncesionit dhe për ushtrimin e të drejtave koncesionare, si dhe zvendësuesit dhe të ngarkuarit e lejuar të këtyre personave duke përfshirë çdo agjent ose perfaqësues për një person ose persona të tilla dhe duke përfshirë një aksioner ose një filial të një aksionari, që do të ndihmojë Koncesionarin në financimin e objektit të koncesionit.
- 1.27. **"E Drejta për Kalim"** do të thotë e drejta për të kaluar mbi, midis, në, prej dhe nën Shesh, dhe në çdo pjesë të tij, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të, pa ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë me qëllimin e zbatimit të kësaj kontrate gjatë periudhës së koncesionit.
- 1.28. **"Shesh"** do të thotë sheshi që gjendet rreth lumit Valbone, që përfshin të gjithë sipërfaqen, godinat, rrugët lidhëse dhe objektet e tjera, që lidhen me hidrocentralet si objektin e kësaj kontrate në përputhje me termit e referencës të përcaktuara në Dokumentat Standarde të Tenderit.
- 1.29. **"Gëzim i qetë"** do të thotë e drejta ekskluzive për të zënë, përdorur dhe gëzuar Sheshin (duke përfshirë Objektet Ekzistuese), ujën e lumit Valbone dhe të Drejtën për Kalim gjatë periudhës së koncesionit, në përputhje me këtë kontrate, pa ndërhyrje të parregullt nga Autoriteti Kontraktues ose nga ndonjë Entitet Shtetëror.
- 1.30. **"Faji":** Faji i Koncesionarit ose i Shoqërisë Koncesionare nënkupton çdo veprim ose mosveprim të Koncesionarit ose të Shoqërisë Koncesionare me dashje ose nga pakujdesia, si rezultat i të cileve Koncesionari nuk përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate. Për të shmangur çdo keqkuptim, mospërmbushja e detyrimeve si rezultat i fakteve, veprimeve apo mosveprimeve, që janë përtej kontrollit të Koncesionarit, siç janë rrethanat e përmendura në Nenin 20.1, duke përfshirë kryerjen e rinovimeve/mirëmbajtje të hidrocentraleve gjatë periudhave kohore të përcaktuara rregullisht, nuk do të konsiderohen si mospërmbushje me faj të koncesionarit për efekte të zbatimit të kësaj kontrate dhe veçanërisht të Nenit 23.2.

The bottom of the page contains several handwritten signatures in black ink. There are also some faint circular stamps or marks, including one that appears to be a seal or official stamp on the right side. The signatures are scattered across the bottom, some overlapping.



1.31. **Praktika e Industrise se Mire** do të thotë praktikat, metodat, standardet, procedurat dhe rekomandimet që janë në përputhje me Ligjet e zbatuara përgjithësisht në industrinë e prodhimit të energjisë hidroelektrike përsa i përket projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së energjisë hidroelektrike, e cila pritet në mënyrë të arsyeshme të realizohet nga një kontraktor i aftë dhe me eksperiencë, inxhinier ose operator, sipas rastit, në rrethana të njëjta ose të ngjashme; praktika, metoda, standarde dhe procedura të cilat do të përfshijnë, pa kufizim, standardet Shqiptare dhe Evropiane (cilado qofshin më të larta, nga një periudhë kohore në tjetrën).

1.32 **"Filial"**: Shoqeri, e cila është e zotëruar ose kontrolluar nga Koncesionari ne menyre te drejtpërdrejt ose te terthorte ose nga ndonjëri prej antareve te Koncesionarit ose nga Shoqeri te zotëruara apo te kontrolluara prej tyre.

2. Përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe, në këtë Kontratë:

2.1. Njëjësi e përfshin shumësin dhe anasjelltas;

2.2. Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjansë;

2.3. Çdo frazë që fillon me fjalët "duke përfshirë", "përfshin", "në veçanti", "për shembull", "të tilla si apo të ngjashme" do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;

2.4. Titujt e përdorur për nenet, paragrafet, nënparagrafet, Aneksat dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate;

2.5. Referimet në dispozitat dhe Aneksat janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe anekset e kësaj Kontrate;

2.6. Pa paragjykim ndaj paragrafit të mësipërm, nëse ka ndonjë konflikt apo mospërputhje ndërmjet dispozitave dhe Anekseve dhe/ose ndonjë shtojcë të Anekseve dhe/ose çdo dokumenti tjetër që i referohemi në këtë Kontratë, konflikti apo mospërputhja do të zgjidhet sipas rendit të mëposhtëm të përparësisë:

2.6.1. Kërkesat e Autoritetit Kontraktues në procedurën konkurruese;

2.6.2. Oferta e Koncesionarit;

2.6.3. Dispozitat e kësaj kontrate;

2.6.4. Çdo Aneks tjetër dhe shtojcat e tyre;

2.6.5. Çdo dokument tjetër që i referohemi në këtë Kontratë ose çdo dokument tjetër bashkëlidhur kësaj Kontrate.

## Neni 2 Objekti i Koncesionit

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjit "Për koncesionet", i jep Koncesionarit me koncesion të formës BOT

Faqe 6 nga 28

KONTRATE KONCESIONI E FORMES "BOT"

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. To the right, there is a circular stamp with a sunburst emblem in the center and text around the perimeter, which is partially obscured by the signatures. The signatures appear to be from various parties involved in the contract.

(që do të thotë ndërtim, operim dhe transferim i së drejtës së pronësisë dhe operimit, në përfundim të kontratës së koncesionit):

Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e 12 hidrocentraleve, siç percaktohen në piken 3.1 të nenit 3 të kësaj kontrate, dhe transferimin e tyre në përfundim të kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

### Neni 3 Karakteristikat e hidrocentraleve

3.1. Hidrocentralet që do të ndërtohen në rrjedhen e lumit Bushtricë, rrethi Librazhd, do të kenë këto karakteristika:

▪ Skemat e ndërtimit të këtyre HEC-eve do të jenë të tipit me devijacion.

▪ Kuota maksimale e rrjedhës së lumit

(kuota e marrjes së ujit tek hidrocentrali i parë i kaskadës) 1600 m mbi nivelin e detit

▪ Kuota minimale e rrjedhjes së lumit përpara bashkimit

te lumit të Bushtrices me lumit Shkumbin

(kuota e godinës së hidrocentralit të fundit të kaskadës) 385m mbi nivelin e detit

▪ Totali i fuqisë së instaluar 29.770 kW

▪ Prodhimin vjetor mesatar i energjisë elektrike 136,542,426 kWh

▪ Numri i hidrocentraleve jo më shumë se 12 hidrocentrale

### Neni 4 Periudha e Koncesionit

4.1. Koncesioni jepet për një periudhë prej 35 (tridhjetepesë) vjetësh nga Data Efektive dhe përfundon në ditën e përvjetorit të 35-të të Datës Efektive ("Periudha Efektive"). Megjithatë, në rastin e Zgjidhjes përpara afatit 35 vjeçar, Periudha e Koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet tek periudha që fillon nga Data Efektive dhe mbaron në Datën e Zgjidhjes.

4.2. Rastet e zgjatjes së Periudhës së Koncesionit:

4.2.1. Palët bien dakord se për shkaqe që ndikojnë drejtpërdrejt në Projekt (jo të shkaktuara nga Koncesionari) ku përfshihet vetëm Forca Madhore periudha e koncesionit do të zgjatet, në përputhje me kohën e duhur që projekti të konsiderohet si rentabël dhe financiarisht i përshtatshëm në përputhje me analizat financiare të "Vlerës për Para", "IRR" apo çdo lloj analize tjetër të përshtatshme për vlerësime të tilla.

4.2.2. Palët bien dakord se Periudha e Koncesionit do të zgjatet në rastin e një Ngjarjeje të Forcës Madhore, për një periudhë kohe të barabartë me kohën që ka zgjatur Ngjarja dhe

KONTRATE KONCESIONI E FORMES "BOT"



kohën e arsyeshme që nevojitet për riparimin e dëmeve të shkaktuara, me kusht që vetë Ngjarja të ketë zgjatur një periudhë kohe që c kalon 1 (një) muaj.

4.2.3. Në rast mosperputhje midis pikave të sipërpervendura (4.2.1) dhe (4.2.2), Periudha e Koncesionit do të zgjatet në funksion të klauzoles me favorizuese për Koncesionarit.

## KREU II

### TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

#### Neni 5

##### Të drejtat koncesionare - Sheshi

##### 5.1. Dhënia e të Drejtave Koncesionare

Që në Datën e Hyrjes në Fuqi, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit, i cili i pranon të drejtat ekskluzive për të gjithë Afatin:

- i. të projektojë, financojë, ndërtojë, testojë, të ketë në pronësi, të operojë dhe të mirëmbajë Hidrocentralin;
- ii. t'i zgjerojë e shtojë Objektet Ekzistuese, nese ka, të ketë në pronësi pjesët e Objekteve Ekzistuese të zgjeruara a të shtuara, kur është e mundur të bëjë veçimin e këtyre pjesëve në përputhje me Ligjin, dhe të shfrytëzojë dhe mirëmbajë Objektet Ekzistuese.
- iii. në varësi të Nenit 5.2 më poshtë, të ketë Gëzim të Qetë;
- iv. me mbarrimin e Afatit t'i kthejë sërish Autoritetit Kontraktues përdorimin e Sheshit dhe të Drejtën për Kalim, dhe t'i transferojë Autoritetit pronësinë e Hidrocentraleve dhe të Objekteve Ekzistuese të shtuara, nese ka; si dhe, në çdo rast, t'i kryejë ato veprime, të cilat janë të pazgjidhmërisht të lidhura me këto aktivitete (së bashku, "të Drejtat Koncesionare");
- v. Koncesionari do të ketë të drejtën ekskluzive ndaj çdo atributi mjedisor që mund të gjenerohet nga Projekti, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në çertifikatat CER;
- vi. Autoriteti Kontraktues do të mbeshtese çdo aplikim që mund të dorëzohet nga Koncesionari tek autoritetet perkatese në lidhje me Mekanizmat e Zhvillimit të Pastertise (Clean Development Mechanism) dhe veçanerisht në lidhje me marrjen e miratimit nga Ministria e Mjedisit, në cilësinë e autoritetit kombëtar të caktuar (DNA) (me kusht që Autoriteti Kontraktues të mos mbahet përgjegjes në rast të mosmarrjes së këtij miratimi).

##### 5.2. Dhënia e Sheshit

Pamvarësisht nga sa parashikohet në Nenin 5.1 më sipër, Sheshi, e Drejta për Kalim, Gëzimi i Qetë do të konsiderohen se i jepen koncesionarit vetëm pasi Koncesionari të pajisë Autoritetin Kontraktues me kopje autentike të çertifikatave siguruese që vërtetojnë (në një masë të arsyeshme të

Faqe 8 nga 28

KONTRATE KONCESIONI E FORMES "BOT"

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. There are also circular official stamps, one of which is partially visible and contains the word "DIREKTORAT". The signatures are scattered across the bottom, some overlapping the text of the previous section.



kënaqshme për Autoritetin Kontraktues), se Koncesionari është pajisur me policat e sigurimit dhe garancitë e kërkuara për këtë qëllim në përputhje me nenin 15 të kësaj kontrate.

Në lidhje me dhënien e Sheshit, të Drejtës për Kalim, Gëzimit të Qetë dhe të drejtës për akses dhe për të përdorur ujin e lumit Valbonë, Koncesionari e pranon Sheshin "siç është" që nga data e një dhënieje të tillë, si dhe Autoriteti Kontraktues nuk do të kryejë ndonjë shpenzim, as nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë Pretendim përkundrejt Koncesionarit, në lidhje me gjendjen e Sheshit.

Pavaresisht nga sa me sipër, në rast se për dhënien e sheshit do të konsiderohet i nevojshëm shpronësimi i truallit që është prone private, atëherë Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha dokumentet dhe informacionet e nevojshme, të cilat do të gjykohen të nevojshme nga Koncesionari dhe në marrëveshje me Autoritetin Kontraktues, duke përfshirë edhe identifikimin e sakte të parcelave që do të shpronësohen.

Autoriteti Kontraktues do të miratojë propozimet për shpronësim dhe do të ndjekë procedurat e shpronësimit sipas dispozitave ligjore përkatëse, me kusht që të gjitha kostot dhe shpenzimet që lidhen me sa më sipër të përballohen nga Koncesionari.

Në rast se Autoriteti Kontraktues, pas paraqitjes së një kërkesë për shpronësim nga Koncesionari, nuk e miraton atë në përputhje me këtë nen ose nuk ndjek procedurat përkatëse në përputhje me ligjin, Koncesionari ka të drejtën e demshperblimit për të gjitha dëmet ose shpenzimet e tjera që lidhen me këtë mospërbushje të Autoritetit Kontraktues, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm tek të drejtat që rrjedhin nga Veprimet Shtetërore Thelbesisht në Kundërshtim me Marrëveshjen.

## Neni 6

### Monitorimi dhe Mbikqyrja e Përgjithshme

#### 6.1. Monitorimi

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë që në periudha kohore prej 3 muajsh, gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues mund të ushtrojë këtë monitorim në çdo kohë me kusht që Autoriteti Kontraktues të disponojë informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve të kësaj Kontrate.

#### 6.2. Mbikqyrja e përgjithshme e punimeve

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të ushtrojë mbikqyrje të përgjithshme me afate tre mujore, gjatë realizimit dhe funksionimit të hidrocentraleve, nëpërmjet të autorizuarve prej tij dhe në prani të koncesionarit, me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit. Autoriteti Kontraktues duhet t'i bejë Koncesionarit një njoftim paraprak të arsyeshëm. Në çdo rast, mbikqyrja nuk duhet të shkaktojë ndonjë pengesë të paarsyeshme, të nderhyjë në zhvillimin e ndertimit ose të ndërprejë ndertimin padrejtësisht.



Ne rast se gjate monitorimit dhe mbikëqyrjes se përgjithshme konstatohen shkelje te kontrates, koncesionari do te njoftohet me shkrim per masat qe do te merren dhe detyrat e tij, sidhe menyren dhe afatet e zbatimit te tyre.

### 6.3 Kostot dhe procesverbalet e monitorimit dhe mbikëqyrjes

Autoriteti Kontraktues do te marre persiper kostot e monitorimit dhe mbikëqyrjes se ndertimit. Rezultatet e monitorimit dhe mbikëqyrjes do te hartohen me shkrim dhe do te nenshkruhen nga te dyja palet. Ne rast se Autoriteti Kontraktues konstaton se Koncesionari ka shkelur kete kontrate, procesverbali per monitorimin dhe mbikëqyrjen duhet te permbaje edhe masat qe Koncesionari duhet te ndermarre dhe detyrimet qe duhen permbushur, si dhe menyren dhe afatet e kesaj permbushje.

## Neni 7

### Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr persiper detyrimet e mëposhtme:

- 7.1. Të sigurojë vazhdimësinë e kësaj kontrate pavarësisht ndryshimeve të objektivave të Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar.
- 7.2. Autoriteti Kontraktues, merr persiper dorëzimin e Sheshit, Te Drejtes Per Kalim, Gezimit te Qete, apo te Objekteve Ekzistuese (nese ka).
- 7.3. Autoriteti Kontraktues me kërkesë të Koncesionarit merr persiper të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar këtë të fundit tek organet shtetërore për çdo pengesë që mund të haset në kuadër të pajisjes me leje, licenca, autorizime apo çdo lloj tjetër leje që nevojitet për ekzekutimin e punimeve dhe operimin e kësaj vepre.  
  
Ky parashikim nuk është i zbatueshëm kur mospajisja me leje, licensë, autorizim, etj, vjen si rezultat i mospërmbushjes së kërkesave ligjore përkatëse për shkak të Koncesionarit.
- 7.4. Autoriteti Kontraktues merr persiper proceduren e shpronësimit për token ne te cilen do te shtrihen hidrocentralet, me kerkese te Koncesionarit, i cili do te përmbushë kërkesat ligjore për kete shpronësim.
- 7.5. Të miratojë projektin e Zbatimit të hidrocentralit, të përgatitur nga vetë Koncesionari, në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në procedurën e garës.
- 7.6. Të ndihmojë Koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate.
- 7.7. Të garantojë, nëse kërkohet nga Koncesionari, detyrimin e subjektit të furnizimit të energjisë elektrike për të blerë te gjithë ose pjese te energjisë elektrike të prodhuar nga këto

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. There are approximately seven distinct signatures. To the right of the signatures, there is a circular official stamp, partially obscured by the ink. The stamp contains text in Albanian, including 'REPUBLIKA E SHQIPERISE' and 'MINISTRI I ENERJES', along with a date and time. The signatures are written over the bottom portion of the page, below the footer text.

hidrocentrale deri ne sasine e 15 MW, përmes kontrate/kontratave afatgjata në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- 7.8. Të garantojë Koncesionarin që ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen e projektit të Koncesionarit.
- 7.9. T'i garantojë Shoqërisë Koncesionare ekskluzivitetin për realizimin e kontrates së koncesionit gjatë periudhës së koncesionit. Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë të kryejë veprime që ndikojnë në pakesimin, ndryshimin apo derivimin e prurjeve të ujit. Në rast se vërtetohen rrethana të tilla, Autoriteti kontraktues është i detyruar të marrë të gjitha masat për riparimin e veprimeve të kryera dhe të përgjigjet për humbjen e pesuar dhe fitimin e munguar të Koncesionarit.
- 7.10. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për detyrimet ligjore dhe kontraktore në rast të mospërmbljes së këtyre detyrimeve nga ana e tij duke shpërblyer të gjitha dëmet e shkaktuara Koncesionarit për shkak të shkeljes së Kushteve të përcaktuara në kontratën e koncesionit.

### KREU III TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT

#### Neni 8

#### Detyrimet e Koncesionarit

- 8.1. Koncesionari është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektin e Kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Koncesionari duhet që:

Të themelojë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit, shoqërinë koncesionare, që do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.

Me krijimin e shoqërisë së re koncesionare, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me këtë kontratë do të transferohen nga Koncesionari tek Shoqëria Koncesionare duke filluar që nga data e regjistrimit të Shoqërisë Koncesionare në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Koncesionari dhe shoqëria e re e krijuar do të jenë solidarisht përgjegjës për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë kontratë.

Një kopje e aktit të themelimit, statutit dhe regjistrimit të shoqërisë së re si person juridik, do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, për të marrë miratimin e këtij të fundit, duke patur parasysh që miratimi i këtij të fundit të jepet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentit përkatës. Në rast vonese për shprehjen e miratimit, konsiderohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka vërejtje apo sugjerime në lidhje me themelimin

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. On the right side, there is a circular official stamp of the Ministry of Energy, with the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRIE' and 'MINISTRI I ENERJISË' visible. The signatures are scattered across the bottom, some overlapping the stamp and others to the left and right.

e personit të ri juridik. Në mënyrë të veçantë kërkohet që në përmbajtjen e Statutit të përfshihen të paktën:

- i. Forma e shoqërisë: Forma e shoqërisë do të jetë "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "shoqëri aksionere", duke funksionuar në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- ii. Objekti i shoqërisë: Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve, siç përcaktohen në pikën 3.1 të nenit 3 të kësaj kontrate, tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike, në zbatim të kësaj Kontrate Koncesioni. (Nuk lejohet asnjë lloj tjetër veprimtarie tregtare përveç atyre që ushtrohen në kuadër të kësaj Kontrate);
- iii. Kohëzgjatja: Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me afatin e kësaj Kontrate Koncesioni;
- iv. Themeluesi i shoqërisë: Shoqëria e re do të themelohet vetëm nga Koncesionari.

- 8.2. Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues, për miratim projektin e zbatimit, brenda 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
- 8.3. Të marrë të gjitha lejet dhe licencat e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 8.4. Të zbatojë preventivin e paraqitur sipas Aneksit I bashkëlidhur kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 9 "Vleresimi i Investimeve";
- 8.5. Të marrë masa që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuara dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;
- 8.6. Të zbatojë projektin për ndërtimin e hidrocentraleve me fuqi totale të vendosur jo më pak se 29,770 kW
- 8.7. Të administrojë projektin për periudhën e koncesionit;
- 8.8. Të kërkojë nëse e gjen me interes dhe të përshtatshme, zbatimin e detyrimit të Autoritetit Kontraktues sipas pikës 7 të nenit 7, më sipër.
- 8.9. Të ndermarre të gjitha masat e nevojshme për parandalimin dhe kontrollin në lidhje me çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë punim i tij.
- 8.10. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen për faj të Koncesionarit, Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta.
- 8.11. Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
- 8.12. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.
- 8.13. Koncesionari nuk duhet të ndërhyjë në burimet ujore që furnizojnë ujësjellësin e zonës;

Page 12 nga 28

KONTRATE KONCESIONI E FORMES "BOT"

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. On the right side, there is a circular official stamp of the 'Autoriteti Kontraktues' (Contracting Authority) with a central emblem. A large, stylized signature is written over the stamp. Below the stamp, there is another signature and a circular mark that appears to be a signature or a stamp.

- 8.14. Koncesionari duhet të marrë masa për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit në fuqi për ruajtjen e ekosistemit natyror, si dhe të sasisë së ujit ekologjik në shtratin parësor të burimit ujor (lumit/përroit) në përputhje me rregullat ligjore në fuqi;
- 8.15. Koncesionari duhet të sigurojë ujin e nevojshëm për vaditje, në përputhje me nevojat e bujqësisë dhe legjislacionin në fuqi për rezervat ujore.
- 8.16. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;
- 8.17. Koncesionari ka të drejtë, te disponoje, kundrejt zgjedhjes së tij, te kryejë transaksione me pale te treta dhe te shese pjesen e tij të energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet, duke përfshirë edhe transaksionet që kanë për qëllim marrjen e çertifikatave të gjelbërta apo ndonjë nxitje tjetër ekuivalente, që ka të bëjë me prodhimet e energjive të rinovueshme, dhe vecanerisht në lidhje me Mekanizmat e Zhvillimit të Pastër ( Clean Development Mechanism ) në kuadrin e Protokollit të Kyoto duke patur parasysh parashikimin e pikës 8.8 të këtij neni.
- 8.18. Në kuadrin e zbatimit të punimeve për realizimin e projektit, bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.2.2001, "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", Koncesionari është i detyruar të emërojë një subjekt në rolin e mbikqyrësit të punimeve. Ai mund të jetë person fizik, juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e kesaj veprimtarie.
- 8.19. Të paguajë shpenzimet noteriale te kesaj kontrate.
- 8.20. Shoqëria koncesionare ka te drejte te transferoje kuotat/aksionet me perparesi tek te trefet, duke ju përmbajtur kufizimit tek neni 17.1.
- 8.21. Shoqëria koncesionare ose Koncesionari ka te drejte te regjistroje pronesine mbi HEC -et dhe asetet qe do te krijohen ne zbatim te projektit te punimeve sipas legjislacionin ne fuqi, per periudhen e kontrates se koncesionit, si dhe ta vendosi ne hipoteke, peng, apo çdo lloj barre tjetër. Ajo ka te drejte te lidhe çdo marreveshje financimi me çdo pale finacuese , me kufizimin e vendosur ne nenin 17.2.

## Neni 9 Vlerësimi i Investimeve

- 9.1. Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 2,189,218,387 (dymiliard e njëqindtëdhjetenentemilion e dyqindtëmbëdhjetemije e treqindtëdhjeteshtate) lekë, sipas Aneksit nr. 1 bashkelidhur, nga te cilat 779,840,031 (shtateqindeshtatedhjetenentemilion e tetëqindedyzetmijetridhjetenje) lekë, do të investohen në makineri e pajisje.
- 9.2. Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:
- pas variantit përfundimtar të projektzbatimit;

KONTRATE KONCESJONI E FORMES "BOT"

Faqe 13 nga 28



- në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës;

- 9.3. Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 2,189,218,387 (dymiliard e njeqindetetedhjetenentemilion e dyqindetetembdhjetemije e treqindetetedhjeteshtate) lekë lekë, por jo më e vogël se 1,970,296,548 (njemiliard e nenteqindeshtatedhjetemilion e dyqindentetdhjetegjashtemije e peseqindedyzetetete) lekë, që përfaqeson një ndryshim të investimit në vlerën 10 % (dhjete përqind) të investimit total të parashikuar.

### Neni 10 Programi punimeve


Konçesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve :

- 10.1. Konçesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 30 ditësh nga data e lëshimit të lejes së ndërtimit. Aplikimi për pajisjen me leje ndërtimi, do të kryhet brenda 30 ditëve nga data e miratimit të projektzbatimit përfundimtar nga Autoriteti Kontraktues.
- 10.2. Konçesionari merr përsipër të verë në punë hidrocentralin brenda 30 (tridhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e kontrates. Afati i ndërtimit është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në Aneksin 2, bashkëlidhur.
- 10.3. Keto afate do të ndryshohen dhe do të zgjaten nëse ndodh:

- (i) Rast i forces mëdhorë (sipas përcaktimeve të Nenit 20) dhe rrethana objektivist të pandalshme nga Konçesionari;
- (ii) Mospermbushje e detyrimeve të Autoritetit kontraktues sipas kësaj kontrate;
- (iii) Vonesa e autoriteteve shtetërore ose publike, në lidhje me lëshimin e lejeve përkatëse dhe të nevojshme për Konçesionarin me qëllim përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj kontrate;
- (iv) Zbulimi i relikave kulturore, arkeologjike, fosile, turma varrezash dhe përmendore, mbetje të kaluara artistike dhe çdo send tjetër me vlera arkeologjike, gjeologjike dhe historike në vendndodhjen e Sheshit, që rezultojnë në kryerjen e punëve publike që shkaktojnë ndërhyrje në përfundimin e Punimeve nga Konçesionari;
- (v) Marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit nëse marrja e lejeve nga Institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për lëshimin e tyre, për arsye që janë jashtë kontrollit të Konçesionarit.

Konçesionari do të ketë gjithashtu të drejtën për kompensim të detyrues të shkaktuar nga keto vonesa, duke përfshirë edhe të drejtat që rrjedhin nga Veprimet Shtetërore Thelbesisht në Kundërshtim me Marrëveshjen.

- 10.4 Koha e shtyrjes do të jetë e barabartë me kohën e vonësës së shkaktuar nga vonesat përkatëse.

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. There are also circular official stamps, one of which is partially visible on the right side. The signatures appear to be from various parties involved in the contract, including the concessionaire and the contracting authority.

- 10.5 Në keto afate nuk përfshihet edhe koha e parashikuar për testimin e veprës të parashikuar në Nenin 11 të kësaj kontrate.

### Neni 11 Testimi i veprës

- 11.1. Në përfundim të punimeve, duhet të kryhet testimi i veprës, për të siguruar funksionimin e hidrocentralit. Testimi do të fillojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të bërë nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
- 11.2. Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Koncesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të hidrocentralit, brenda 60 ditëve nga fillimi i testimit, duke patur parasysh kompleksitetin e veprës.
- 11.3. Në rast mospjesëmarrjeje të Autoritetit Kontraktues gjatë testimit, Koncesionari ka të drejtë të kryejë vetë testimin dhe vënien në punë të veprës, duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 30 ditëve nga testimi dhe vënia në punë. Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë edhe rezultatet e testimit. Pas marrjes nga Autoriteti kontraktues të këtij njoftimi Autoriteti kontraktues do të njoftojë me shkrim Koncesionarin brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, nëse rezultatet e testimit janë të kënaqshme apo të pamjaftueshme sipas të dhënave dhe kërkesave teknike të përcaktuara në këtë kontrate. Testimit do të konsiderohet i përfunduar nëse në rast mungese të njoftimit me shkrim

### Neni 12 Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit

- 12.1. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Autoriteti Kontraktues.
- 12.1.1. Koncesionari nuk fillon punën për 6 muaj (për shkak të tij) nga data e marrjes së lejes së ndërtimit sipas nenit 10.1. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14.
- 12.1.2. Në rast të mosrealizimit për faj të koncesionarit të fuqisë së vendosur mbi 10 % të asaj sipas projektit të propozuar nga Koncesionari.
- 12.1.3. Kur shoqëria koncesionare transferon aksionet/kuotat me përparësi tek të tretet pa marrë miratimin e Autoritetit kontraktor.
- 12.1.4. Kur Koncesionari braktis punimet e zbatimit për më shumë se 100 (njëqind) ditë të njëpasnjëshme. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14 si dhe hidrocentralin siç është në momentin e braktisjes, pa patur asnjë detyrim të çdo lloji karshi koncesionarit apo shoqërisë koncesionare.



Handwritten signatures of the parties involved in the contract.

12.1.5. Kur shoqëria e re koncesionare është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi, për faj të koncesionarit. Nëse është e aplikueshme, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14.

12.1.6. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nuk çliron Koncesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e kontratës deri në momentin e dorëzimit të hidrocentraleve tek Autoriteti Kontraktues. Palët bien dakord që dorëzimi do të bëhet brenda një afati kohor prej 60 ditësh, duke filluar nga momenti i zgjidhjes.

Nëse ky detyrim nuk përmbushet nga Koncesionari atëherë, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e hidrocentraleve, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë.

#### 12.2. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Koncesionari;

Koncesionari, ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë kur Autoriteti Kontraktues është në shkëlqe serioze të detyrimeve të tij kontraktore (duke përfshirë edhe Veprimet Shtetërore Thelbesisht në kundërshtim me Marrëveshjen) dhe nuk e korrigjon këtë shkëlqe, brenda afatit të përcaktuar në pikën 12.4 të këtij neni. Në këtë rast koncesionari ka të drejtë të tetheqë mbrapsht Sigurimin e Kontratës

#### 12.3. Zgjidhja e kontratës nga secila palë;

Secila nga palët ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur:

12.3.1. Megjithë plotësimin e kriterëve nga ana e koncesionarit për aplikim për leje, licenca në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ndërhyrjen e Autoritetit Kontraktues, koncesionari nuk është pajisur me to, për fillimin e punimeve dhe/ose operimin e Projektit.

12.3.2. Në rastet e parashikuara nga neni 20 pika 20.3 e kësaj kontrate

#### 12.4. Njoftimi i zgjidhjes së kontratës;

Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate në përputhje me këtë nen, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër. Njoftimi duhet të përmbajë:

- i. Detajet e duhura duke nënvizuar shkakun e zgjidhjes;
- ii. Datën e përfundimit të kontratës, në rast të moskorrigjimit të shkëlqes brenda 30 ditëve nga data e njoftimit;
- iii. Hollësitë e llogaritjes së pagesave si rezultat i zgjidhjes së kontratës;
- iv. Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

#### 12.5. Zgjidhja e kontratës me konsensus;

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. To the right, there is a circular official stamp with a star in the center and text around the perimeter, partially overlapping the signature area. The signatures are scattered across the bottom, with some appearing to be initials or full names.



Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm, duke negociuar mënyrën e kompensimit të investimit. Në çdo rast Koncesionari ka të drejtë të terheqë mbrapsht Sigurimin e Kontrates

#### 12.6. Të Drejtat e Palëve Financuese dhe zëvendësimi i koncesionarit:

##### 12.6.1. Njoftimi i Palëve Financuese:

Menjëherë pas marrjes dijeni për shkelje serioze nga ana e koncesionarit të detyrimeve kontraktore, që çenojnë zbatimin dhe operimin e koncesionit ose sjellin si pasojë zgjidhjen e kontratës sipas pikave 12.1.2, 12.1.3, 12.1.4, 12.1.5 e 12.1.6 të nenit 12 të kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues përveç njoftimit të koncesionarit sipas pikës 12.4 të këtij neni, njofton edhe Palën Financuese me qëllim dhënien e një mundësie, kësaj të fundit, për të ndihmuar koncesionarin për të korrigjuar ose marrë masa për të rregulluar këto shkelje brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e një njoftimi të tillë. Autoriteti Kontraktues i jep Palës Financuese ndihmesë të arsyeshme për këtë qëllim.

##### 12.6.2. Zëvendësimi i Koncesionarit

Në rast se nuk është bërë i mundur korrigjimi i shkeljes nga koncesionari, Pala Financuese (nëse e gëjkon me interes) zgjedh, të ndërhyjë duke i propozuar Autoritetit Kontraktues, transferimin e Projektit në duart e një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues i cili duhet që të ketë, ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjëndjen financiare të paktën të barazvlershme me atë të Koncesionarit;

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues nuk do të pengojë apo vonojë pa arsye, pëlqimin e tij dhe do të bëjë ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash në lidhje me Palën Kontraktuese.

Zëvendësuesi, do të ketë të drejtën e menaxhimit/administrimit të projektit dhe do të realizojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit, por nuk do të ketë të drejtë të shesë, të transferojë, të vendosë barra sigurorese mbi hidrocentralin.

12.6.3. Nëse Pala Financuese vendos të mos ushrojë të drejtat e parashikuara në këtë nen, ose nëse edhe pas ushtrimit të këtyre të drejtave nuk arrihet në një zgjidhje të arsyeshme për vashdimësinë e projektit, kontrata do të zgjidhet.

#### 12.7. Pagesat në rast zgjidhjeje të Kontratës:

12.7.1. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga Autoriteti Kontraktues për faj të Koncesionarit.

Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit shumat e papaguara (duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm tek kostot e papaguara, shpenzimet, që lidhen me zgjidhjen e kontrates ose shpenzime të tjera, duke përfshirë edhe rastet e procedurave të përshpejtuara) sipas Dokumentave Financiare deri në masën e investimit ose të angazhimit për investim (te cilat janë të dokumentuar rregullisht) për realizimin e projektit.

The bottom of the page contains several handwritten signatures in black ink. There are also two circular stamps: one on the right side, partially overlapping the text, and another one below it. The signatures are written over a horizontal line.

12.7.2. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga Koncesionari për faj të Autoritetit Kontraktues.

Zgjidhja e Kontrates nga Koncesionari për faj të Autoritetit Kontraktor ose Veprime Shtetërore Thelbesisht në Kundershtim me Marreveshjen. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit (i) shumën e papaguara (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në kostot e parapaguara, shpenzimet dhe tarifën që lidhen me Zgjidhjen e kontratës ose shpenzime të tjera duke përfshirë edhe rastin e procedurave të përsheptuara) sipas Dokumenteve Financiare në masën e investuar ose të angazhimit për investim (te cilat janë të dokumentuara rregullisht) për realizimin e projektit, (ii) shumën e kontribuar nga ortaket tek Shoqëria Koncesionare deri në masën e investuar ose të angazhuar për tu investuar (te cilat janë të dokumentuara rregullisht) për realizimin e projektit, dhe (iii)  $(35 - \text{Numrin e viteve të kaluara deri në datën e Zgjidhjes}) \times 0,6 \times$  (Kthimi Mesatar mbi shumën nga ortaket tek Shoqëria Koncesionare për periudhën prej 3 vitesh të njëpasnjëshëm që i paraprin Zgjidhjes)  $\times$  (vlera mesatare shumes së kontribuar nga ortaket tek Shoqëria Koncesionare për periudhën prej 3 vitesh të njëpasnjëshëm që i paraprin Zgjidhjes

Zgjidhja e kontratës për shkak të Forcës mëdhe të zgjatur (nga secila prej paleve). Në këtë rast Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit (i) shumën e papaguara (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në kostot e parapaguara, shpenzimet dhe tarifën që lidhen me Zgjidhjen e kontratës ose shpenzime të tjera duke përfshirë edhe rastin e procedurave të përsheptuara) sipas Dokumenteve Financiare në masën e investuar ose të angazhimit për investim (te cilat janë të dokumentuara rregullisht) për realizimin e projektit, (ii) shumën e kontribuar nga ortaket tek Shoqëria Koncesionare deri në masën e investuar ose të angazhuar për tu investuar (te cilat janë të dokumentuara rregullisht) për realizimin e projektit,

Gjithsesi, Koncesionari ka të drejtë të kërkojë Sigurimin e Kontratës nëse ekziston.

### Neni 13 Kontratat

- 13.1. Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontratë tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit. Në të gjitha kontratat, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate koncesioni.
- 13.2. Koncesionari nuk ka të drejtë të nënkontrakttojë asnjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, për vlera më të mëdha se 50% të vlerës së investimit, pa marrë miratimin paraprak, me shkrim, të Autoritetit Kontraktues. Për mënjanimin e ndonjë keqkuptimi furnizuesit e pajisjeve, materialeve dhe/ose dërgesave nuk do të konsiderohen nënkontraktore sipas kësaj Kontrate.
- 13.3. Miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktues nuk nevojitet për nënkontraktore të mirënjohur në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar, në gjendje të mirë financiare.

Page 48 nga 28

KONTRATE KONCESIONI E FORMES "BOT"

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. There are also circular stamps, one of which is partially visible on the right side. The signatures are scattered across the bottom, some overlapping each other.

- 13.4. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk shpreh mendimin e tij brenda 30 ditësh nga marrja dëjoni, miratimi do të konsiderohet i dhënë.
- 13.5. Koncesionari është përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktues individualisht dhe solidarisht me nënkontraktuesin, për përmbushjen e detyrimeve nga ana e nënkontraktuesit.
- 13.6. Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

#### Neni 14 Sigurimi i kontratës

- 14.1. Koncesionari, para nënshkrimit të kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, shumën prej 218,921,839 (dyqindtetenibedhjetemilion e nentëqindnjetëzetënjemije e teteqindetridhjetenente) leke, që përbën 10 % të vlerës totale të investimit. Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkëlidhet kësaj kontrate.
- 14.2. Koncesionarit i lejohe të ç'ngurtësojë këtë vlerë duke u ndare kjo vlerë sipas përfundimit të secilit hidrocentral në përqindjen që zë secili objekt me vlerën e përgjithshme të investimit.
- 14.3. Sigurimi i Kontratës do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, të detyrimeve të Koncesionarit në lidhje me përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe përfundimin e testimit.

#### Neni 15 Sigurimet

- 15.1. Koncesionari në çdo kohë do të pajiset, mbaje dhe ripërterije ato garanci sigurimi të kerkuara në lidhje me ushtrimin e të Drejtave Koncesionare dhe përdorimin e Objekteve Ekzistuese (nëse ka), dhe do t'i percjelle, ose do të kujdeset që t'i percillen Autoritetit Kontraktues kopjet e certifikuara të çdo çertifikate sigurimi pas marrjes së një njoftimi të arsyeshëm paraprak prej Autoritetit Kontraktues.
- 15.2. Koncesionari duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 të nenit 7 të Ligjit 9267 dt.29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" gjatë gjithë periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit, brenda një afati 15 ditor nga data e sigurimit.
- 15.3. Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë operimit të objektit vlera e dëmit e kompensuar nga siguroresi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të përdoret për të

*(Handwritten signatures and stamps are present at the bottom of the page, including a circular stamp on the right side.)*

rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit. Pjesa e zbritshme nga shuma që siguruesi do të paguaje për kompesimin e dëmit do të perballohet nga koncesionari.

- 15.4 Koncesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.
- 15.5 Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200 000 Euro për çdo ngjarje dhe 500 000 Euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 Euro për çdo ngjarje dhe 2000 Euro në vit.
- 15.6 Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

#### Neni 16

#### Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

##### 16.1 Tarifa koncesionare

Gjatë Fazës së Shfrytëzimit, Koncesionari detyrohet t'i japë Autoritetit Kontraktues pa pagesë 7.2% (shitate pike dy perqind) të Prodhimit Vjetor të Energjisë Elektrike ("Tarifa e Koncesionit").

Kjo tarifë nuk do të jetë objekt ndryshimesh deri në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit.

Tarifa koncesionare do të jepet nga Koncesionari dhe do të merret në dorëzim nga KESH ose OST në emër të Autoritetit kontraktues në Piken e Levritimit.

Koncesionari nuk do të mbaje asnjë përgjegjësi në lidhje me detyrimet për pagese të tarifës koncesionare në rast se energjia elektrike e furnizuar nuk do të merret në dorëzim nga KESH ose OST në emër të Autoritetit Kontraktues.

##### 16.2 Vlera e Riinvestimit

Duke filluar nga viti i 25-të nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, Koncesionari do të riinvestojë 60 % të vlerës së investimit për makineri dhe pajisje, sipas një grafiku që do të hartohet nga palët për këtë qëllim.. Kjo vlerë do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

#### Neni 17 Kufizimet

- 17.1. Për çdo transferim të aksioneve/ kuotave me perparësi të kapitalit themeltar të saj tek të tretët Shoqëria e re Koncesionare duhet të marrë pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktues.
- 17.2. Shoqëria e re që do të krijohet, sipas nenit 8.1, dhe/ose Koncesionari ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që do të krijohen në zbatim të projektit të punimeve si dhe të lidhë çdo lloj marrëveshje financimi me çdo Palë Financuese, me kusht

Page 20 nga 28

KONTRATE KONCESIONI E FORMES "BOT"



The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. To the right, there is a circular official stamp with text around the perimeter, including 'REPUBLIKA E SHqipëRI' and 'MINISTRI I ENERJISË DHE MINDRI I UJËVE'. The signatures are written over the stamp and extend across the bottom of the page.

që hipoteka, pengu apo barra tjetër si dhe marrëveshja përkatëse e financimit t'i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të Koncesionarit në këtë Kontratë.

### Neni 18 Raportimi

18.1. Koncesionari është i detyruar që çdo tre (3) muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

### Neni 19 Legjislacioni i zbatueshëm

19.1. Zbatimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate Koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar.

### Neni 20 Forca Madhore

20.1. Konsiderohen Ngjarje të Forcës Madhore çdo ngjarje ose rrethanë, ose kombinim i ngjarjeve ose rrethanave që teresisht ose pjesërisht parandalojnë çdo pale nga përmbushja e detyrimeve sipas kësaj Kontrate.

20.2. Ngjarje të Forcës Madhore përfshin, por nuk kufizohet në, ngjarjet dhe rrethanat e mëposhtme:

- (i) çdo veprim lufte (qoftë kjo e deklaruar apo jo) lufte civile, pushtim, konflikt i armatosur ose veprim i një armiku të jashtëm, proteste ose terrorizem, në secilin rast përfshin ose drejtpërdrejtë ndikon në Republikën e Shqipërisë;
- (ii) revolucion, proteste, rebelim ose çdo kryengritje civile, akt terrorizmi ose sabotimi që në secilin rast përfshin ose drejtpërdrejtë ndikon në Republikën e Shqipërisë;
- (iii) grevat që kanë përhapje të gjera dhe ose janë kombëtare dhe ose politike;
- (iv) Katastrofat e natyrës, çdo termet, vershim ujrash, thatësire natyrore, zjarr, uragane ose fatkeqësi mjedisore dhe natyrore dhe çdo ngjarje e barabartë me to, që ndikon drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë në Zonën e Koncesionit;
- (v) ndotje nukleare, kimike ose biologjike që drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë ndikon në Zonën e Koncesionit.
- (vi) epidemi ose infeksione që drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë ndikojnë në Zonën e Koncesionit.
- (vii) çdo ngjarje e barabartë që mund të ndikojë në objektin e kësaj kontrate, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të marrëveshjes, që kanë të bëjnë me vullnetin e paleve.

Faqe 21 nga 28

KONTRATE KONCESIONI E FORMES "BOT"

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. There are also circular official stamps, one of which is partially visible on the right side. The signatures are scattered across the bottom, some overlapping each other.



20.3. Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 30 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e përmbushjes së detyrimeve në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe të vazhdojnë kontratën. Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore. Kufijtë e përmbushjes së detyrimeve, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre. Periudha e koncesionit do të zgjatet në përputhje me nenin 4.2 të kësaj kontrate.

20.4. Zgjidhja e kontratës për shkak të forcës madhore.

Kontrata do të zgjidhet kur:

- i. në rast se edhe pas zbatimit të pikës 20.2 të këtij neni, nuk është arritur një zgjidhje në të mirë të projektit,
- ii. kur forca madhore zgjat më tepër se 6 muaj.

~~20.5. Pasoja e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore.~~

Në rastet e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore, Autoriteti kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit :

- (i) kompensimin që i korrespondon çdo shume të papaguar (duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm tek parapagimet e kostove, demet e tërthorta shpenzime të tjera që lidhen me Zgjidhjen e kontratës ose shpenzime të tjera duke përfshirë edhe rastin e procedurave të përshpejtuara) sipas Dokumenteve Financiare në masën e investuar ose të angazhimit për investim (të cilat janë të dokumentuara rregullisht) për realizimin e projektit,
- (ii) shumën e kontribuar nga ortaket në Shoqërinë Koncesionare në masën e investimeve të kryera ose të angazhimeve të investimeve (të cilat janë të dokumentuara rregullisht) për rrealizimin e Projektit( minus të ardhurat e sigurimit që do të zvogelojnë çdo shume të papaguar sipas Instrumenteve Financiare

Gjithësesi, Koncesionari ka të drejtë të kërkojë Sigurimin e Kontratës nëse ekziston.


20.6. Zgjidhja e mosmarrëveshje që vijnë si pasojë e forcës madhore do të bëhet në përputhje me nenin 23 të kësaj kontrate.

#### Neni 21

#### Veprim Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Marrëveshjen

21.1 "Veprim Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Marrëveshjen" (ose "VSHKM") do të thotë çdo veprim ose mosveprim pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, i kryer nga një Entitet Shtetëror, dhe që pasjell Pasoja Thelbësisht në Kundërshtim me Marrëveshjen.

21.2 Veprimi Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Marrëveshjen do të përfshijë rrethanat e mëposhtme (nëse ato sjellin Pasoja Thelbësisht në Kundërshtim me Marrëveshjen):

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. To the right, there are two circular official stamps. The first stamp is partially obscured by a signature and contains the text 'INSTRUMENTEVE FINANCIARE' and 'PËR SHËNIMIN'. The second stamp is also partially obscured and contains the text 'KONTRATE KONCESIONI E FORMES "BOT"'. The signatures are written over the text of the document.

- mosdhënien ose vonesën jo normale në dhënien e Autorizimeve të nevojshme (duke përfshirë Licencat) Konçesionarit për qëllime të përmbushjes së rregullt nga Konçesionari të detyrimeve të tij dhe të realizimit detyrues të të drejtave të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, në çdo kohë deri në mbarim të Afatit, me kusht që megjithatë Konçesionari të ketë përmbushur të gjitha detyrimet e tij, si dhe me kusht që, sidoqoftë, ushtrimi i ligjshëm dhe i arsyeshëm i të drejtave të veta nga çdo Entitet Shtetëror për të kërkuar ndryshime të caktuara në Projektin e Detajuar si kusht për lëshimin e ndonjë Autorizimi (duke përfshirë Lejen e ndërtimit) nuk do të përbëjë VSHKM;
- shpronësimin, marrjen, konfiskimin ose shtetëzimin e Hidrocentralit dhe/ose të Drejtave Konçesionare;
- mosdhënien e sheshit, gezimit të qete ose të drejtave të njëjta mbi Sheshin dhe Objektet Ekzistuese (për sa është e mundur) nga Autoriteti Kontraktues në dobi të Konçesionarit, pa pagesë, në çdo kohë deri në mbarim të Afatit;
- ndalimi ose kufizimi i riatdhësimit ose transferimit të fitimeve ose të të ardhurave të Konçesionarit dhe të shërbimeve për detyrimet parësore (sipas Dokumenteve Financiare) nga Republika e Shqipërisë (duke përfshirë ndalimin dhe kufizimet në këmbimin e monedhave të huaja);
- çdo nxjerrje ose ndryshim Ligji të natyrës mjedisore dhe teknike (duke përfshirë ndryshimet në Kodin e Rrjetit ose në Kodin e Sistemit të Transmetimit), i cili do ta bënte Ligjin më të shtrënguar se sa rregullat ose rregulloret e Bashkimit Evropian, në atë kohë në fuqi, përsa i përket në thelb të njëjtës çështje; ose
- çdo nxjerrje ose ndryshim Ligji që synon drejtpërdrejt Projektin dhe/ose projektet e ngjashme me Projektin dhe/ose që diskriminon Konçesionarin.
- Çdo vendim i ndonjë Rregullatori, që sjell si pasojë zvogëlimin e Pagesave të Blerësit sipas Marrëveshjes së Shitjes së Energjisë (dhe siç është përcaktuar këtu), do të trajtohet si VSHKM për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

21.3 Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi drejtuar Autoritetit Kontraktues për një Veprim Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Marrëveshjen, Autoriteti Kontraktues do të sigurojë ndreqjen e VSHKM në fjalë.

21.4 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin të sigurojë ndreqjen e VSHKM para mbarimit të periudhës tridhjetë (30) ditore, Palët do të zhvillojnë menjëherë bisedime me qëllim që të arrijnë një zgjidhje të kënaqshme të dyanshme për të rivendosur Konçesionarin në pozitën që do të kishte qenë nëse ky Veprim Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Marrëveshjen nuk do të kishte ndodhur (duke përfshirë kompensimin për kostot dhe humbet e munguara). Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin të ndreqë ose të rivendosë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga fillimi i këtyre bisedimeve (ose nëse Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur ose ka refuzuar të zhvillojë bisedime), Konçesionari do të ketë të drejtë ta zgjidhë këtë Marrëveshje.

21.5 Konçesionari nuk do të përjashtohet nga përmbushja e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje pasi ndodh një Veprimi Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me

Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page, including a circular stamp on the right side.

Marrëveshjen, përveç kur Pasoja Thelbësisht në Kundërshtim me Marrëveshjen që e shoqëron atë, shkakton mospërbushjen e detyrimeve të përmendura për Konçesionarin, me kusht që, më tej, Afati do të zgjatet automatikisht për aq sa zgjat Veprimi Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim me Marrëveshjen.

#### Neni 22

#### Hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit

22.1. Kontrata e Koncesionit do të hyjë në fuqi pasi të nënshkruhet nga palët, në përputhje me Ligjin Nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", i ndryshuar.

#### Neni 23

#### Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

23.1. Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.

23.2. Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, do të jetë Gjykata e Arbitrazhit, që do të krijohet dhe funksionojë sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë. Gjykimi do të bëhet nga një grup prej 3 arbitrash, nga ku secila palë zgjedh një arbitër dhe këta dy arbitra zgjedhin arbitrin e tretë.

23.3. Fillimi apo vazhdimi i negociatave për zgjidhje me dialog, apo i procedurave gjyqësore të arbitrazhit nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.

23.4. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve nëpërmjet procedurës së arbitrazhit do të jetë e zbatueshme vetëm në rast se nuk bie ndesh me ndonjë rrethane, fakt apo ngjarje që e bën të pamundur ekzekutimin e këtyre procedurave. Në këtë rast, mosmarrëveshja do të jetë objekt gjykimi nga gjykata e shkallës së parë Tiranë.

#### Neni 24

#### Sanksionet

24.1 Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, në përfundim të periudhës të parashikuar në nenin 10 të kësaj kontrate, penalizon Konçesionarin si më poshtë:

- i. Per shkelje të afatit të ndërtimit 0,05 % në ditë të vlerës së investimeve të munguara.
- ii. Per moskryerje në total të investimeve për vlerën e të cilës është rënë dakord sipas nenit 9.3, Konçesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të paralizuar.
- iii. Per çdo ditë vonese për fillimin e punimeve penalizohet me shumën 10.000 Leke.

Këto penalitete do të mbahen nga Sigurimi i Kontrates parashikuar në nenin 14 me sipër, duke patur parasysh se nëse vlera e këtij sigurimi nuk është mjaftueshme për shlyerjen e penaliteteteve, Konçesionari do t'a plotësojë këto shume, rast pas rasti.

Faqe 24 nga 28

KONTRATE KONCESIONI E FORMES "BOT"

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. There are also circular official stamps, one of which is partially visible on the right side. The signatures are written over a horizontal line that separates the main text from the footer information.



24.2 Mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike dhe fuqisë së vendosur per faj te koncesionarit sipas kushteve të rena dakord me këtë kontratë, penalizon Koncesionarin si më poshtë:

- i. Në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 136,542,426 kWh/vit,
- ii. Koncesionari penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të pa realizuar për periudhën raportuese, duke patur parasysh se në këtë rast Autoriteti Kontraktues do ta marrë të plotë tarifën koncesionare prej 7.2 % (për sasi prej 9,831,055 kWh/vit). Në rast kur prodhimi nuk realizohet për shkak të tjera (jo për faj të koncesionarit), Koncesionari nuk penalizohet për prodhimin e munguar; nderkaq, Koncesionari është i detyruar të paguaje tarifën koncesionare, në vlerën prej 7.2 % të prodhimit të realizuar.
- iii. Për mosrealizim për faj të koncesionarit deri në 10 % të fuqisë së vendosur, precaktuar sipas nenit 3 të kësaj kontrate, Koncesionari penalizohet në shumën e llogaritur si më poshte:
- iv. ~~Shuma e penalitetit =~~ Prodhim vjetor i energjise elektrike x Fuqia e pinstaluar ( në % ) x Vitet e operimit si te llogaritura ne oferte x Çmimi i shitjes se energjise elektrike vendosur nga ERE ne momentin e kryerjes se testimit te veprës sipas nenit 11 te kësaj kontrate x Fee Koncesionare (në %).
- v. Ky penalitet do të aplikohet në momentin e testimit të veprës në përputhje me nenin 11 të kësaj kontratë.


24.3 Palet bien dakord që sanksionet e parashikuara në paragrafin 24.2 do të zbatohen deri në një vlerë prej 10 % të vlerës së investimit, për gjithë periudhën e koncesionit. Sanksionet do të llogariten çdo fund viti kalendarik, sipas një akti rakordimi të përbashkët që bëhet ndërmjet palëve të kësaj Kontrate.

24.4 Mosparaqitja në kohë e projektit të zbatimit për miratim nga Autoriteti Kontraktues, si e parashikuar në nenin 8, pika 2 të kësaj kontrate koncesionare, e penalizon Koncesionarin me 0,005 % të vlerës së investimit për çdo dite vonese.

24.5 Sanksionet paguhen në llogari të Autoritetit Kontraktues. Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të diskutojnë për një periudhë 30 ditore lidhur me shkeljen dhe në rast se palet nuk janë dakord zgjidhet sipas nenit 23 të kësaj kontrate.

24.6 Kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 20 ditësh. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.

24.7 Aplikimi dhe pagimi i penaliteteve sipas ketij neni nuk e çliron koncesionarin nga permbushja e detyrimeve dhe parashikimeve te kësaj kontrate

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. There are also two circular official stamps, one of which is partially visible and contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËS' and 'MINISTRI I ENERJISË ELEKTRIKE'. The signatures are scattered across the bottom, some overlapping the text of the previous paragraph.

**Neni 25**  
**Rregullimi i shkeljeve**

25.1 Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së koncesionit, Koncesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Koncesionarit duke pritur për një periudhë 40 ditore përgjigjen e tij, me argumentat përkatëse. Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.

25.2 Kjo procedurë nuk e përjashton Koncesionarin nga detyrimi për të paguar dëmet që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimeve kontraktore, të cilat janë përcaktuar në këto kontrate ose në mungesë të ketyre përcaktimeve, atyre detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin shqiptar përkatës.

~~Neni 26~~  
**Transferimi i Aseteve**

26.1. Me mbarimin e kontratës, Koncesionari do të kryejë çdo veprim të nevojshëm për dorëzimin tek Autoriteti Kontraktues, të asetëve të marra në dorëzim nga ai, ato të realizuara nga Koncesionari gjatë periudhës së koncesionit si dhe çdo titull mbi to, të zhveshura nga çdo lloj detyrimi, barre apo hipoteke.

Proçesi i Dorëzimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit me një inspektim të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.

26.2. Koncesionari, duhet të transferojë pa kundërshpërblim në favor të Autoritetit Kontraktues:

- i. hidrocentralin dhe objektet ekzistuese të lidhura me të;
- ii. ndërtesa, makineri, pajisje;
- iii. pronësinë mbi ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga ai;
- iv. të drejtat kontraktore ;
- v. dorëzimin e librave, dokumentave dhe garancive që shoqërojnë këto asete;
- vi. çdo të drejtë tjetër të fituar nga ai nëpërmjet kësaj kontrate;

26.3. Koncesionari, duhet të provojë se këto asete janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të mirë pune, duke marrë parasysh normën e amortizimit përkatës.

Në rast se kontrata është zgjidhur për shkak të forcës madhore, koncesionari duhet të provojë se gjendja ekzistuese e asetëve ka ardhur si pasojë direkte e saj.

26.4. Çdo e drejtë që koncesionari ka fituar me këtë kontratë, do të mbahet me transferimin e projektit.

26.5. Kostot e transferimit të projektit do të përballohen nga koncesionari, përveç rastit kur zgjidhja e kontratës ka ardhur për faj të Autoritetit Kontraktues.



**Neni 27**  
**Mbarimi i kontratës**

27.1. Kontrata koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 35 vjeçar, duke patur parasysh parashikimet e Nenit 4 të kësaj kontrate.

27.2. Mbarimi i kontratës si përfundim i afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

26.3. Një vit para përfundimit të kësaj periudhe, palët me vullnet të përbashkët, mund të zgjasin afatin e kësaj kontrate, kur vlerësohet se nga ana e Koncesionarit janë përmbushur me korrektësi të gjitha detyrimet dhe Autoriteti Kontraktues e konsideron me interes vazhdimësinë e kontratës.

**Neni 28**  
**Konfidencialiteti**

28.1. Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'jā bërë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

**Neni 29**  
**Ndryshime**

29.1. Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve.

29.2. Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

**Neni 30**  
**Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit**

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të bëhet vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët, dhe mund të dërgohet personalisht (dorazi) ose dërgohet me anë të postës së regjistruar me parapagim ose me postë të shpejtë në adresën e Palës tjetër.


Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 10 (dhjetë) ditor nga data e ndryshimit.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkohet Autoritetit Kontraktues nga koncesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate.

Adresat dhe numrat e kontaktit që do të perdoren gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje janë:

Faqe 27 nga 28

KONTRATE KONCESIONI E FORMES "BOT"



Për Autoritetin Kontraktues

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë  
dhe Energjetikës  
Blvd. Zogu i Parë, Nr. 1001,  
Tiranë - Shqipëri

Për Koncesionarin

Shoqëria "Erniku" shpk  
Adresa: Sheshi Rilindja Qendra e Biznesit "Karl  
Gega" Kulla 2, Kati 2  
Tel: +355 692023775

**Neni 31**  
**Rregjistrimi i Kontratës**

Brenda 30 ditëve nga miratimi i projektit të zbatimit, kjo Kontratë duhet të regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kjo kontratë u hartua në 3 (tri) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALET

AUTORITETI KONTRAKTUES

CONCESIONARI

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë  
dhe Energjetikës

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive  
"L.N.K" sh.p.k, "Erniku" sh.p.k, "A.S.K Oil" sh.a  
dhe "Loshi Bl." sh.p.k,

Përfaqësuar nga :

Shoqëria « LNK » shpk  
Përfaqësuar nga :

z. Genc RILI

z. Taip KURTI

*Genc Rili*

*Taip Kurti*



Shoqëria « Erniku » shpk  
Përfaqësuar nga :

z. Iljaz SPAHIU

*Iljaz Spahi*



Shoqëria « A.S.K Oil » sha  
Përfaqësuar nga :


z. Andi KUME

*Andi Kume*  
Shoqëria « Loshi Bl. » shpk  
Përfaqësuar nga :



z. Bajram I. ...

*Bajram I.*



*Faiz Mehmet*  
*Faiz Mehmet*

KONTRATE KONCESIONI E FORMES "BOT"

*[Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page]*

# S T A T U T

## I SHOQËRISË TREGTARE "Bushtrica Energy 2009" Sh.p.k.

### KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Emërtimi

Shoqëria emërtohet "Bushtrica Energy 2009" Sh.p.k.

#### Neni 2 Forma juridike

Shoqëria Tregtare "Bushtrica Energy 2009" Sh.p.k themelohet si Shoqëri Tregtare me përgjegjësi të kufizuar.  
Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.  
Shoqëria krijohet në zbatim të Kontratës "Për Bashkëpunim të Përkohshëm të Shoqërive" nr. 6067 Rep dhe nr. 2607 Kol. datë 28.08.2009. Palët bien dakort qe me ane te dispozitave te ketij statuti te zbatojne ate kontrate.

#### Neni 3 Afati

Shoqëria krijohet për një afat kohor të pakufizuar.  
Shoqëria mund të vendos prishjen e saj me vendim unanim të Asamblesë së Përgjithshme të zakonshme ose të jashtëzakonshme të ortakëve.


#### Neni 4 Selia

Selia e Shoqërisë Tregtare "Bushtrica Energy 2009" Sh.p.k ndodhet në qytetin e Librazhdit me adresë "Lagjia 1, Pall 7, Shk 1"

Në varësi të aktivitetit tregtar shoqëria mund të hapë degë apo filiale të saj në qytete të ndryshme të Shqipërisë ose jashtë vendit, sipas legjislacionit të vendit përkatës.

#### Neni 5 Ligjshmëria

PULLE TAKSE



Firma

Firma

Faqe 1 nga 12

Firma

Firma

1

Veprimtaria e Shoqërisë bazohet në Aktin e Themelimit, Statutin si dhe në Legjislacionin Shqiptar në fuqi.  
Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet që mund të kenë ortakët themelues para krijimit të saj, si dhe për detyrimet e ortakeve para futjes në shoqëri apo për shkak të veprimtarive të tjera.

### Neni 6

#### Objekti i Veprimtarisë së shoqërisë

Shoqëria do të ketë si objekt të vetëm të veprimtarisë së saj :

Financim, projektim, ndërtim, vënie në punë, administrim dhe mirëmbajtje e hidrocentraleve në lumin Bushtrica nga kuota 390 metra deri në kuotën 1450 metra dhe transferimi i tyre nga koncesionari tek autoriteti kontraktues sipas kontratës së koncesionit të firmosur ndërmjet palëve krijuese të shoqërisë dhe Ministrisë së Energjetikës.

Shtimi apo pakësimi i objektit të veprimtarisë së shoqërisë do të bëhet me vendim të Asamblese së Përgjithshme të ortakëve me shumicë prej 3/4 të votave sipas ndarjes së votave të përcaktuar në nenin 17 të këtij statuti.

### KREU II

#### ORGANIZIMI I SHOQËRISË

### Neni 7

#### Drejtimi i shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Administratorët bashkërisht
- Asambleja e Përgjithshme e zakonshme ose e jashtëzakonshme e ortakëve.

### Neni 8

#### Administrimi

Administrimi i shoqërisë bëhet nga Administratorët që është një organ i përbërë detyrimisht nga dy persona fizik.

Administratorët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve. Mandati i administratorit është prej 5 (pesë) vjetësh duke nisur nga dita e nënshkrimit të këtij statuti për Administratorët e caktuar në këtë statut dhe nga dita e marrjes së vendimit nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve për Administratorët e zgjedhur prej saj.

Secili ortak i cili ka mbi 20% të kuotave të kapitalit themeltar ka të drejtën për të propozuar dhe patur një administrator për drejtimin e shoqërisë.

Firma

Firma

Faqe 2 nga 12

Firma

Firma 2



Administratori i parë propozohet nga ortaku A.S.K. OIL Sh.à dhe emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me shumicë sipas parashikimeve të këtij neni.

Administratori i dytë propozohet nga ortaku "L.N.K" Sh.p.k. dhe "Loshi BL" sh.p.k. dhe emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve me shumicë sipas parashikimeve të këtij neni.

Administratori i parë propozohet nga ortaku Erniku sh.p.k. dhe emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me shumicë sipas parashikimeve të këtij neni.

Në zbatim të këtij paragrafi dhe në bazë të nenit 88 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ortakët bien dakort që, në përjashtim me ndarjen e votave të bërë në nenin 17 dhe me dispozitat e Kontratës Për Bashkëpunim të Përkohshëm të Shoqërive nr. 6067 Rep dhe nr. 2607 Kol. datë 28.08.2009, për çështjen e votimit për emërimin e administratoreve, secili ortak për emërimin e administratorit të tij do të gezojë shumicën e zakonshme të votave që do të thote 510 të drejta vote. Ortakët e tjerë të shoqërisë gjatë votimit për emërimin e administratorit të dytë gëzojnë pjesën e mbetur prej 410 të drejta vote.

Administratori mund të rizgjidhet.

Asambleja e Përgjithshme e zakonshme ose e jashtëzakonshme mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë për një arsye të drejtë.

Asambleja vendos shkarkimin e Administratorit me shumicë prej 3/4 të votave sipas ndarjes së votave të përcaktuar në nenin 17 të këtij statuti.

**Administratori i parë i Shoqërisë "Bushtrica Energy 2009" Sh.p.k. do të jetë Z. Xhezmi Kadi i datëlindjes 16/8/1959 dhe mbajtës i pashaportës nr. Z 1033917.**

**Administratori i dytë i Shoqërisë "Bushtrica Energy 2009" Sh.p.k. do të jetë Z. Luan Kurti i datëlindjes 10/01/1938 dhe mbajtës i pashaportës nr. Z 1751360.**

**Administratori i trete i Shoqërisë "Bushtrica Energy 2009" Sh.p.k. do të jetë Z. Xhavit Ujkani i datëlindjes 12/01/1949 dhe mbajtës i pashaportës nr. Z 1851279**



### Neni 9

#### Kompetencat e administratorit

Administratorët ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm bashkërisht.  
Administratorët nuk mund të kryejnë veprime në emër të shoqërisë pa miratimin me shkrim të administratorit tjetër.

Firma

Firma

Page 3 nga 12

Firma

Firma

3

Në veçanti, me përjashtim të parashikimeve specifike të bëra në këtë Statut, Administratorët nuk mund të disponojnë asnjëlloj pasurie të shoqërisë pa miratimin dhe firmën e administratorit tjetër.

Financimi i shoqërisë nga palë të treta, që nuk janë ortakë të saj, mund të bëhet vetëm me aprovimin e Asamblesë së Përgjithsme të ortakeve me shumice prej  $\frac{3}{4}$  e votave dhe nënshkrimin e të dy Administratorëve.

Administratorët bashkërisht kanë të gjitha kompetencat për drejtimin e Shoqërisë me qëllim që shoqëria të realizoj objektin e saj.

Administratorët nuk kanë ato kompetenca që ligji dhe statuti ua njeh shprehimisht Asamblesë së ortakeve.

Administratorët përfaqësojnë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët si dhe përpara organeve administrative dhe gjyqësore.

Administratorët bashkërisht kanë veçanërisht këto kompetenca :

- Miratimi i llogarive vjetore dhe paraqitja e tyre sipas rastit për miratim përfundimtar Asamblesë së Ortakëve.
- Redaktimi i rregulloreve të brendshme të shoqërisë.
- Krijimi i strukturave të reja brenda shoqërisë apo çdo organi tjetër të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.

○ Përzgjedhja e ekspertëve kontabël dhe të anëtarëve të komisionit të likuidimit.

- Organizimi i mbledhjeve të Asambleve të Përgjithshme të ortakëve mund të bëhet edhe nga vetëm një administrator.

- Lëshojnë certifikatën e aftësisë paguese sipas nenit 77 të Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Në përjashtim të sa më sipër:

1 - Administratorët mund të kryejnë të vetëm, pa pasur nevojë për miratimin e administratorit tjetër, veprime të të njëjtit lloj, natyrë dhe/ose operacion që nuk tejkalojnë vlerën prej 5 000 euro ose kundërvlera e saj në Lek një afat prej 10 ditësh. Administratori që kryen këto veprime është i detyruar të informojë administratorin tjetër në takimin e tyre më të parë.

2 - Administratori i parë përfaqëson i vetëm shoqërinë për nënshkrimin e kontratave për financimin nga ortakët "Erniku" shpk dhe "A.S.K. Oil" sh.a. si dhe për projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin dhe mirëmbajtjen e hidrocentraleve në lumin Bushtrica nga kuota 815 metra deri në kuotën 500 metra. Për kryerjen e veprimeve të parashikuara në këtë paragraf administratori i parë detyrohet të hap një llogari bankare në emër të shoqërisë e cila duhet të përdoret ekskluzivisht nga ai dhe duhet të shërbejë ekskluzivisht për kryerjen e këtyre veprimeve.

3 - Administratori i dytë përfaqëson i vetëm shoqërinë për nënshkrimin e kontratave për financimin nga ortaku "L.N.K" sh.p.k. dhe ortaku "Loshi BL" sh.p.k. si dhe për projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin dhe mirëmbajtjen e hidrocentraleve në lumin Bushtrica nga kuota 1450 metra deri në kuotën 820 metra dhe nga kuota 500 metra deri në kuotën 390 metra. Për kryerjen e veprimeve të parashikuara në këtë paragraf administratori i dytë detyrohet të hap një llogari bankare në emër të

shoqërisë e cila duhet të përdoret ekskluzivisht nga ai dhe duhet të shërbejë ekskluzivisht për kryerjen e këtyre veprimeve.  
Administratori që do të tejkalojë përcaktimet e këtij statuti angazhon përgjegjësinë e tij penale për shpërdorim detyre.

#### Neni 10

#### Asambleja e Përgjithshme e ortakëve

Organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

Asambleja e jashtëzakonshme mund të thirret në çdo kohë nga Administratori ose nga një ortak që përfaqëson më shumë se 5% të kuotave të kapitalit themeltar.

Nëse asambleja thirret nga një ortak sipas paragrafit të mësipërm, ortaku i bën kërkesë Administratorit që të kryhen veprimet e nevojshme për mbledhjen sa më të shpejtë të Asamblesë. Nëse Administratori nuk përgjigjet brenda 3 ditëve, refuzon ose pranon por nuk kryen veprimet brenda një afati 5 ditor ortaku që ka bërë kërkesën mund të bëjë të gjitha veprimet për organizimin e mbledhjes.

#### Neni 11

#### Asambleja e Përgjithshme e zakonshme e ortakëve

Asambleja e zakonshme e Ortakëve vendos miratimin e llogarive vjetore me shumicë prej 3/4 të votave sipas ndarjes së votave të përcaktuar në nenin 17 të këtij statuti, emërimin ose riemërimin e ekspertëve kontabël me shumicë prej 3/4 të votave sipas ndarjes së votave të përcaktuar në nenin 17 të këtij statuti, shpërndarjen e fitimit pas lëshimit të çertifikatës së aftësisë paguese sipas përcaktimeve të nenit 20 të këtij statuti dhe çdo kompetencë të njohur shprehimisht nga ligji.

Në zbatim të nenit 87 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Asambleja e Përgjithshme e zakonshme e Ortakëve vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit në çdo nen të tij, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, financimin nga pale të treta investitore, banka etj, riorganizimin, ndarjen ose prishjen e shoqërisë.

Njoftimi për mbledhjen bëhet nga Administratori, me letër rekomande, të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes.

Njoftimet duhet të përmbajnë vendin, datën e mbledhjes dhe rendin e ditës. Çdo ortak mund të kërkojë përfshirjen në rendin e ditës të Asamblesë të një çështjeje. Kërkesa për përfshirjen e një çështjeje i drejtohet Administratorit i cili ua komunikon ortakëve të tjerë me letër rekomande ose gjatë seancës së Asamblesë.

Firma


Firma

Faqe 5 nga 2

Firma

Firma

5



Administratori angazhon përgjegjësinë e tij civile nëse nuk u komunikon kërkesën ortakëve të tjerë. Në këtë rast ortaku që ka bërë kërkesën mund të kërkoj gjatë zhvillimit të Asamblesë që kërkesa të shqyrtohet nga Asambleja, Asambleja nuk mund të refuzoj shqyrtimin e kërkesës.

### **Neni 12 Vendimmarrja**

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme drejtohet nga Administratorët e shoqërisë.

Asambleja e ortakëve emëron një nga pjesëmarrësit si sekretar për mbajtjen e proces - verbalit të mbledhjes.

Nëse Asambleja nuk arrin të vendos emërimin e sekretarit, sekretari emërohet nga Administratorët.

Vendimet e mbledhjes si dhe kërkesat e çdo ortaku përmbledhen në proces - verbalin e firmosur nga Administratorët, Ortakët e pranishëm dhe sekretari.

Nëse në mbledhjen e Asamblesë nuk kanë qenë të pranishëm të gjithë ortakët e shoqërisë, proces - verbalit i bashkëngjiten kopjet e provave që ortakët kanë qenë thirrur në mënyrë të rregullt.

Nëse vendimi i Asamblesë së përgjithshme të ortakëve është marrë pa u thirrur të gjithë ortakët nga administratori, ortakët që nuk kanë qenë thirrur mund të kërkojnë pranë Gjyqates së Rrethit Gjyqësor Tiranë anulimin e vendimit të Asamblesë nëse ky vendim ka dëmtuar interesat e tyre ose të shoqërisë.

Kërkesa parashkruhet për 2 vjet.

Në proces - verbal mund të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur me kërkesë të ortakëve, deklaratat e bëra prej tyre.

Vendimet e mbledhjes, të marra në përputhje me ligjin, Aktin e Themelimit ose Statutin janë të detyrueshme për secilin Ortak, edhe në qoftë se nuk ka marrë pjesë në mbledhje por ka qenë i thirrur në mënyrë të rregullt.

### **Neni 13 Ekspertët Kontabël**

Shoqëria cakton dy ekspert kontabël për çdo vit financiar. Emërimi bëhet nga Asambleja e Ortakëve me propozim të Administratorëve. Ekspertët Kontabël mund të emërohen dhe shkarkohen vetëm bashkërisht. Shkarkimi ose dorëheqja e një Eksperti Kontabël për çfarëdo arsyeje sjell automatikisht dhe shkarkimin e Ekspertit tjetër Kontabël.

Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të dokumentacionit financiar të Shoqërisë.

Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesit, administratorët, personat që janë gjini e krushqi me ta deri në shkallën e tretë.

Firma

Firma

Faqe 6 nga 12

Firma

Firma

6

Gjithashtu kjo detyrë nuk mund të kryhet nga përgjegjësit e zyrave, filialeve e agjensive të shoqërisë.

#### Neni 14 Ortakët

Ortakët kanë të drejtë të pakufizueshme për të tërhequr një kopje të çdo dokumentacioni që lidhet me administrimin e shoqërisë në përgjithësi dhe me vendimet e marra nga organet e shoqërisë në veçanti.

Ortaku që kërkon një kopje të një dokumenti të përcaktuar në mënyrë specifike, ka të drejtë që të kërkojë autentifikimin e këtij dokumenti nëpërmjet firmës së Administratorit të shoqërisë dhe vendosjes së vulës së shoqërisë.

Nëse Administratori nuk përgjigjet ose refuzon firmosjen dhe/ose vendosjen e vulës në kopjen e dokumentit, ortaku kërkues ka të drejtë të ripërsërisë kërkesën me anë të një letre rekomande të adresuar tek selia e shoqërisë.

Nëse brenda një afati 10 ditor nga mbërritja e letrës rekomande në shoqëri, Administratori nuk ka kthyer përgjigje me shkrim, ortaku kërkues ka të drejtë të mbledhë Asamblenë e Përgjithshme të jashtëzakonshme të ortakëve të shoqërisë me rend dite shkarkimin e administratorit për faj të rëndë ose ti drejtohet Gjykatës Territoriale kompetente e cila mund të shkarkojë administratorin nëse konstaton një faj të rëndë.

Ortaku kërkues disponon gjithashtu të drejtën e kërimit të një dëmshpërblimi nga Administratori në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të vendndodhjes së selisë së shoqërisë.

Ortakët, brenda mundësive konkrete, kanë të drejtë të marrin dijeni minimumi 15 ditë para çdo mbledhjeje asambleje të materialeve dhe projekt vendimeve që do të diskutohen në atë mbledhje.

Çdo ortak joadministrator ka të drejtë dy herë në vit t'i paraqesë me shkrim administratorit disa pyetje për ato probleme që venë në dyshim vazhdueshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë.

Administratori duhet të përgjigjet brenda një afati 10 ditor.

Përgjigja e administratorit i komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar nëse ka.

Ortakët kanë të drejtë që të paraqesin propozime për shqyrtim para organeve të Shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë tu delegojnë përfaqësuesve të tyre të përhershëm ose të përkohshëm ushtrimin e të drejtave të tyre në shoqëri me anë të një prokure noteriale.

Secili prej ortakëve ka të drejtë të kërkojë prej administratorëve nënshkrimin e një kontrate për realizimin prej tij të punimeve të nevojshme, për llogari të shoqërisë, në bazë të parashikimeve dhe ndarjes së përcaktuar në nenin 9 dhe 20 të këtij statuti.

#### Neni 15 Transferimi i kuotave

Firma

Firma

Faqe 7 nga 12

Firma

Firma



Kuotat e kapitalit të shoqërisë janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Ortaku që kërkon të shesë kuotat e tij një personi të tretë duhet detyrimisht tu ofrojë ortakëve të shoqërisë blerjen e kuotave të tij në të njëjtat kushte si personit të tretë të cilit ai dëshiron tia shesë. Në rast se disa ortakë ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes dhe shprehin dëshirën e tyre për të blerë kuotat, Ortaku shitës gëzon të drejtë diskrecionare për të zgjedhur se cilit ortak ai dëshiron ti shesë totalisht ose pjesërisht kuotat e tij.

Ortakët duhet të përgjigjen brenda 30 ditëve nëse dëshirojnë të blejnë kuotat e ofruara apo jo.

### Neni 16

#### Forma e transferimit

Transferimet e kuotave të kapitalit të shoqërisë tek ortakët apo të tretët, duhet të vërtetohen me akt noterial, në të kundërt transferimi konsiderohet i pavlefshëm.

### KREU III

#### ASPEKTET FINANCIARE

### Neni 17

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është i përbërë nga kontributi i Ortakëve themelues në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë. Të ndarë në 1 000 Kuota me vlerë 1000 lekë. Kapitali themeltar ndahet sipas ndarjes së bërë në nenin 20 të këtij Statuti.

Kapitali themeltar është paguar nëpërmjet kontributit në para nga Ortakët themelues në masën:

28 % prej ortakut **shoqëria "A.S.K Oil" sh.a.** e cila zotëron 28 % të kuotave të kapitalit themeltar ose 280 kuota që i korrespondojnë 280 të drejta vote.

23 % prej ortakut **shoqëria "Erniku" sh.p.k.** e cila zotëron 23 % të kuotave të kapitalit themeltar ose 230 kuota që i korrespondojnë 230 të drejta vote.

39% prej ortakut **shoqëria "L.N.K" sh.p.k.** e cila zotëron 39% të kuotave të kapitalit themeltar ose 390 kuota që i korrespondojnë 390 të drejta vote.

10% prej ortakut **shoqëria "Loshi BL" sh.p.k.** e cila zotëron 10% të kuotave të kapitalit themeltar ose 100 kuota që i korrespondojnë 100 të drejta vote.

Firma

Firma

Faqe 8 nga 12

Firma

Firma

8



### Neni 18 Financimi nga ortakët

Ortakët angazhohen të financojnë shoqërinë nëpërmjet vënies në dispozicion të shoqërisë të një shume në të holla në formën e një overdrafti ose huaje e cila mund të përdoret vetëm sipas mënyrës dhe administratorit të përcaktuar në nenin 9 të këtij Statuti. Ortakët angazhohen të financojnë secili në mënyrë të pavarur nga të tjerët projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin dhe mirëmbajtjen e hidrocentraleve në lumin Bushtrica sipas ndarjes së bërë në nenin 20 të këtij statuti.

Ortakët angazhohen të financojnë shoqërinë secili në mënyrë të pavarur nga të tjerët nëpërmjet ekzekutimit të punimeve të ndryshme të projektimit, ndërtimit, vënies në punë, administrimit dhe mirëmbajtjes së hidrocentraleve në lumin Bushtrica për llogari të saj sipas paragrafit të fundit të nenit 14 dhe ndarjes së bërë në nenet 9 dhe 20 të këtij statuti. Punimet e kryera nga ortakët do të konsiderohen si një hua dhënë shoqërisë e cila duhet të shlyhet vetëm nga të ardhurat e gjeneruara nga shoqëria sipas ndarjes së bërë në nenin 20 të këtij statuti.

Çfarëdolloj financimi i dhënë shoqërisë nga një ortak mund ti rimburohet këtij ortaku vetëm me të ardhurat e gjeneruara nga shfrytëzimi i objekteve të ngritura me financimin e tij sipas ndarjes së bërë në nenin 20 të këtij Statuti. Një ortak nuk mund të kërkojë që shoqëria të shlyejë huanë karshi tij me të ardhurat e gjeneruara nga aktivitetet e financuara nga ortakët e tjerë sipas ndarjes së përcaktuar në nenin 20. Administratori që do të përdorë të ardhurat që burojnë nga një pjesë e aktivitetit të përcaktuar në nenin 20 të këtij statuti për të shlyer detyrimet e shoqërisë karshi një ortaku në kundërshtim me ndarjen e bërë në nenin 20 të këtij Statuti angazhon përgjegjësinë e tij penale për shpërdorim detyre. Ky akt është absolutisht i pavlefshëm në kuptimin e nenit 92 dhe në vijim të Kodit Civil dhe pala që ka përfituar të ardhurat detyrohet ti kthejë ato në shoqëri.

Kushtet dhe menyra e funksionimit të overdraftit duhet të jenë të njëjta me ato të zakoneve bankare në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës së huasë ose overdraftit.

Çdo marrëveshje huaje ose overdrafti e nënshkruar në kushte më të favorshme për ortakun sesa në sektorin bankar angazhon përgjegjësinë civile të ortakut karshi shoqërisë.

### Neni 19 Zmadhimi, zvogelimi i kapitalit dhe ndarja e shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet kur për këtë vendos Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë me një shumicë prej  $\frac{3}{4}$  e votave sipas ndarjes së votave të përcaktuar në nenin 17 të këtij statuti.

Firma

Firma

Faqe 9 nga 12

Firma

Firma

9

Në zbatim të nenit 227 të Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë me vendim të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 49% të kuotave të shoqërisë ndarjen e saj nëpërmjet krijimit të dy apo me shume shoqërive të reja. Nëse respektohen kushtet e parashikuara në këtë Statut, Vendimi për ndarjen e shoqërisë është i vlefshëm edhe nëse kundër tij votojnë ortakët zotërues të 51% të kuotave. Ndarja do të jetë e vlefshme vetëm nëse kjo ndarje miratohet paraprakisht dhe me shkrim nga Ministria e Energjetikës ose nga autoritetet kompetente sipas dispozitave ligjore në fuqi në momentin e ndarjes.

Miratimi shqyrtohet nga Asambleja dhe i bashkëngjitet vendimit të saj. Vendimi i Asamblesë është i pavlefshëm nëse nuk është marrë paraprakisht miratimi i sipërpërmendur dhe nëse ky miratim nuk është shqyrtuar prej saj.

Mënyra e ndarjes së aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë drejtë shoqërive pritëse përcaktohet mbi bazën e ndarjes së bërë në nenin 20 të këtij Statuti. Aktivitetet dhe pasivitetet e shoqërisë do të ndahen shoqërive pritëse mbi bazën e kontributit të secilit ortak në këto aktive dhe pasive (kostot e ndërtimit) që transferohen. Pasivi që nuk mund të atribuohet drejtë për drejtë një prej të dy pjesëve të konçesionit do të ndahet sipas kuotave të secilit ortak në këtë shoqëri.

Projekti dhe Raporti mbi ndarjen e shoqërisë do të përgatitet nga ortaku që kërkon ndarjen dhe duhet të miratohet nga ortaku ose ortakët e tjerë. Në rast të mungesës së miratimit nga një ortak, Projekti dhe Raporti mbi ndarjen e shoqërisë do të përgatitet nga një ekspert kontabël i zgjedhur nga shumica e të gjithë ortakëve. Nëse ortakët nuk arrijnë të zgjedhin një ekspert kontabël atëherë eksperti caktohet me vendim të formës së prerë të gjykatës ku ndodhet selia e shoqërisë.

## Neni 20 Shpërndarja e fitimit

Ortakët financojnë, përfitojnë rimbursim të financimit të tyre dhe ndajnë fitimin e realizuar si më poshtë:

- Tërësia e fitimit të realizuar nga shfrytëzimi i centraleve hidroelektrike të ndërtuara nga kuota 500 metra deri në kuotën 815 metra i takojnë ortakëve **shoqëria "A.S.K. Oil" sh.a.** dhe **shoqëria "Erniku" sh.p.k.**

Tërësia e fitimit do të ndahet në keto raporte: 55 % për ortakun **shoqëria "A.S.K. Oil" sh.a.** (Përkatesisht nga ortakët Xhezmi Kadi me 34% dhe Andi Kume me 21 % të aksioneve) dhe 45 % për ortakun **shoqëria "Erniku" sh.p.k.** Ndarja e fitimeve sipas raporteve të përcaktuara më lart për secilin ortak i korespondon respektivisht financimit në ndërtimin e hidrocentraleve. X

- Tërësia e fitimit të realizuar nga shfrytëzimi i centraleve hidroelektrike të ndërtuara nga kuota 1450 metra deri në kuotën 820 metra i takojnë ortakut **shoqëria "L.N.K" sh.p.k.**

Firma

Firma

Faqe 10 nga 12

Firma

Firma

10

- Tërësia e fitimit të realizuar nga shfrytëzimi i centraleve hidroelektrike të ndërtuara nga kuota 500 metra deri në kuotën 390 metra i takojnë ortakut shoqëria "Loshi BL" sh.p.k.

Perqindja e financimit të secilit ortak për ndërtimin e hidrocentraleve do të jetë e barabartë me perqindjen e ndarjes së fitimeve.

Secili ortak është përgjegjës për realizimin e financimit sipas ndarjeve të bera në nenin 20 të këtij statuti.

Nëse koncesionari penalizohet nga autoriteti kontraktues për moszbatim të kontratës secili ortak është përgjegjës sipas ndarjes të bera në nenin 20 të këtij statuti.

#### **KREU IV PEZULLIMI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË LIKUIDIMI**

##### **Neni 21 Pezullimi i veprimtarisë**

Veprimtaria e Shoqërisë mund të pezullohet.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve vendos pezullimin e veprimtarisë së shoqërisë. Asambleja vendos kohën gjatë së cilës shoqëria nuk do të ushtroj veprimtari.

Vendimi është i vlefshëm nëse ai është votuar me një shumicë prej 3/4 të votave sipas ndarjes së votave të përcaktuar në nenin 17 të këtij statuti..

##### **Neni 22 Prishja e shoqërisë**

Prishja e shoqërisë mund të vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve të shoqërisë.

Asambleja vendos me unanimitetin e të gjithë ortakëve prishjen e shoqërisë. Vendimi që vendos prishjen e shoqërisë duhet gjithashtu të miratojë me shumicë të zakonshme likuidatorin e propozuar nga Administratori i shoqërisë.

Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimit të saj edhe emrin "Shoqëria në Likuidim".

##### **Neni 23 Përfundimi i likuidimit**

Ortakët vendosin me shumicë të zakonshme mbi rregullshmërinë e likuidimit, bilancin e likuidimit dhe përfundimin e mandatit të likuidatorit. Ortakët mund të mblidhen kryesisht ose me kërkesë të likuidatorit.

##### **Neni 24 Refuzimi i mbylljes së likuidimit**

Firma

Firma

Faqe 11 nga 12

Firma

Firma

11

Kur Ortakët, pa shkaqe të arsyeshme, nuk vendosin mbylljen e likuidimit, likuidatori ose çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes së likuidimit, së bashku me llogaritë përkatëse përfundimtare, depozitohen në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Mbas mbylljes së likuidimit e depozitimit të dokumentacionit ne Regjistrin Tregtar, Shoqëria çregjistrohet prej tij.

**KREU V**  
**DISPOZITA TE FUNDIT.**

**Neni 25**  
**Dispozita supletive**

Për çdo çështje të patrajtuar në këtë statut pëlët i referohen legjislacionit Shqiptar në fuqi dhe veçanërisht ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe "Kontratës për Bashkëpunim të Përkohshëm të Shoqërive" nr. 6067 Rep dhe nr. 2607 Kol. datë 28.08.2009 dispozitat e së cilës zbatohen vetëm për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me këtë Statut.

**ORTAKËT THEMELUES**


Shoqëria "A.S.K. Oil" Sh.a.

Shoqëria "Erniku" sh.p.k.



Përfaqësuar nga Administratori  
Z. Andi Kume

Përfaqësuar nga Administratori  
Z. Iljaz Spahiu



Shoqëria "LNK" Sh.p.k.

Shoqëria "Loshi BL" sh.p.k.

Përfaqësuar nga Administratori  
Z. Taip Kurti

Përfaqësuar nga Administratori  
Z. Bajram Loshi



*Bajram Loshi*



*Handwritten signature*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
Notere-SHPRESA GJOCI  
NIPT-NR.61621011S  
Tel-0682071706

NR 6060 REP  
NR 3742 KOL

### AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me daten 02-11- 2009.- DYMIJE E NENTE--une notere Shpresa GJOCI, me seli ne rrugen M.Gjollesha, pallati-ylli kuq, kati i pare- TIRANE, vertetoj se u paraqiten para meje personalisht.

**1- SHOQERIA- A.S.K.OIL SH.A-** me seli Valias -kamez- TIRANE, me numer nipti K 82109004K, perfaqesuar nga administratori Z- ANDI THIMJO KUME, banues ne TIRANE, madhor, me zotesi t e plote juridike per te vepruar, pajisur me pashaport e numer Z 1472536.

**2- SHOQERIA- LOSHI BL SH.P.K.** me seli ne Librazhd, me numer nipti J 67902618M, perfaqesuar nga administratori Z- BARJAM HAJDAR LOSHI, banues ne Librazhd, madhor, me zotesi t e plote juridike per te vepruar, pajisur me pashaport e numer Z 1044592.

**3 SHOQERIA- ERNIKU SH.P.K.** me seli ne TIRANE, me numer nipti J 71925004S, perfaqesuar nga ILJAZ EMRI SPAHIU, banues ne TIRANE, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur personalisht prej meje.

**4-SHOQERIA- LNK SH.P.K.** me seli ne TIRANE, me numer nipti K02003004P, perfaqesuar nga administratori Z- TAIP LUAN KURTI, banues ne TIRANE, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, pajisur me document perkates identifikimi.

Deklaruan se statutin e mesiperm te shoqerise- BUSHTRICA ENERGY 2009\_ SH.P.K. e kane perpiluar dhe nenshkuar konform vullnetit te tyre te lire .  
Une notere ne baze te ligjit-ligjeroj aktin e mesiperm si dhe nenshkrimet e paleve te mesiperm.

NOTERE  
SHPRESA GJOCI



VENDOSËN:

- Miratimin e ndryshimeve ne nenin 6 te statutit te shoqerise duke ndryshuar objektin e veprimtarise. Pas ketyre ndryshimeve ky nen merr permbajtjen e meposhteme;

“ Shoqëria do të ketë si objekt të vetëm të veprimtarisë së saj :

Financim, projektim, ndërtim, vënie në punë, administrim dhe mirëmbajtje e hidrocentraleve në lumin Bushtrica nga kuota 385 metra deri në kuotën 1600 metra dhe transferimi i tyre nga koncesionari tek autoriteti kontraktues sipas kontratës së koncesionit të firmosur ndërmjet palëve krijuese të shoqërisë dhe Ministrisë së Energjetikës.

Shtimi apo pakësimi i objektit të veprimtarisë së shoqërisë do të bëhet me vendim të Asamblese së Përgjithshme të ortakëve me shumicë prej 3/4 të votave sipas ndarjes së votave të përcaktuar në nenin 17 të këtij statuti. ”

- Miratimin e ndryshimeve ne nenin 8 te statutit te shoqerise duke shtuar numrin e administratoreve te shoqerise. Pas ketyre ndryshimeve ky nen merr permbajtjen e meposhtme:

“ Administrimi i shoqërisë bëhet nga Administratorët që është një organ i përbërë detyrimisht nga 4 persona fizik.



Administratorët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve. Mandati i administratorit është prej 5 (pesë) vjetësh duke nisur nga dita e nënshkrimit të këtij statuti për Administratorët e caktuar në këtë statut dhe nga dita e marrjes së vendimit nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve për Administratorët e zgjedhur prej saj.

Administratori i parë propozohet nga ortaku “A.S.K Oil” sh.a. dhe emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me shumicë të zakonshme të votave të përcaktuara sipas ndarjes së votave të bërë në nenin 17.

Administratori i dytë propozohet nga ortaku “L.N.K” Sh.p.k. dhe emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve me shumicë sipas parashikimeve të këtij neni.

Administratori i tretë propozohet nga ortaku “Erniku” sh.p.k. dhe emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve me shumicë sipas parashikimeve të këtij neni.

Administratori i katërt propozohet nga ortaku “Loshi BL” shpk dhe emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve me shumicë sipas parashikimeve të këtij neni.





Në zbatim të këtij paragrafi dhe në bazë të nenit 88 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ortakët bien dakort që, në përjashtim me ndarjen e votave të bërë në nenin 17 dhe me dispozitat e Kontratës Për Bashkëpunim të Përkohshëm të Shoqërive nr. 6067 Rep dhe nr. 2607 Kol. datë 28.08.2009, për çështjen e votimit për emërimin e administratoreve, secili ortak për emërimin e administratorit të tij do të gezojë shumicën e zakonshme të votave që do të thote 510 të drejta vote. Ortaket e tjere gjate votimit për emërimin e administratorit gezojne pjesen e mbetur prej 410 vota.

Administratori mund të rizgjidhet.

Asambleja e Përgjithshme e zakonshme ose e jashtëzakonshme mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë për një arsye të drejtë.

Asambleja vendos shkarkimin e Administratorit me shumicë prej 3/4 të votave sipas ndarjes së votave të përcaktuar në nenin 17 të këtij statuti.

**Administratori i parë i Shoqërisë "Bushtolica Energy 2009" Sh.p.k. do të jetë Z. Xhezmi Kadi i datëlindjes 16/08/1959 dhe mbajtës i pashaportës nr. Z 1033917.**

**Administratori i dytë i Shoqërisë "Bushtolica Energy 2009" Sh.p.k. do të jetë Z. Luan Kurti i datëlindjes 10/01/1938 dhe mbajtës i pashaportës nr. Z1751360.**

**Administratori i tretë i Shoqërisë "Bushtolica Energy 2009" Sh.p.k. do të jetë Z. Xhavit Ujkani i datëlindjes 12/01/1949 dhe mbajtës i pashaportës nr. Z1851279.**

**Administratori i katert i Shoqërisë "Bushtolica Energy 2009" Sh.p.k. do të jetë Z. Ilmi Loshi i datëlindjes 15/04/1977 dhe mbajtës i pashaportës nr. Z2570866.** ”

- Miratimin e ndryshimeve në nenin 20 të statutit të shoqërisë duke ndryshuar mardhënien e ortakëve "A.S.K. OIL" Sha dhe "Erniku" Shpk. Pas këtyre ndryshimeve ky nen merr përmbajtjen e mëposhtme:

“ Ortakët financojnë, përfitojnë rimbursim të financimit të tyre dhe ndajnë fitimin e realizuar si më poshtë:

Tërësia e fitimit të realizuar nga shfrytëzimi i centraleve hidroelektrike të ndërtuara nga kuota 815 metra deri në kuotën 594 metra i takojnë ortakut shoqëria "A.S.K. Oil" sh.a.

Tërësia e fitimit të realizuar nga shfrytëzimi i centraleve hidroelektrike të ndërtuara nga kuota 591 metra deri në kuotën 500 metra i takojnë ortakut shoqëria "Erniku" sh.p.k.

Tërësia e fitimit të realizuar nga shfrytëzimi i centraleve hidroelektrike të ndërtuara nga kuota 1450 metra deri në kuotën 820 metra i takojnë ortakut shoqëria "L.N.K" sh.p.k.

200  
000  
590-000

Tërësia e fitimit të realizuar nga shfrytëzimi i centraleve hidroelektrike të ndërtuara nga kuota 500 metra deri në kuotën 390 metra i takojnë ortakut shoqëria "Loshi BL" sh.p.k. ”

Pasi nuk kishte çështje të tjera për tu diskutuar asambleja deklarohet e mbyllur. Autorizohet Z. Andi Kume të kryej depozitimin e këtij vendimi pranë Qndres Kombetare të Regjistrimit (QKR)

### ORTAKËT THEMELUES

Shoqëria "A.S.K. Oil" Sh.a.

Përfaqësuar nga Administratori

Z. Andi Kume



Shoqëria "LNK" sh.p.k.

Përfaqësuar nga Administratori


Z. Taip Kurti



Shoqëria "Erniku" sh.p.k.

Përfaqësuar nga Administratori

Z. Iljaz Spahiu



Shoqëria "Loshi BL" sh.p.k.

Përfaqësuar nga Administratori

Bajram Loshi

